




AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RAPORT VJETOR 2015



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RAPORT VJETOR 2015

PËRMBAJTJE

1. **MISIONI**
2. **VIZIONI**
3. **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**
4. **AUTORITETI**
5. **KËSHILLI I ANKESAVE**
6. **QEVERISJA E AUTORITETIT DHE ZHVILLIMET ORGANIZATIVE**
 7. Autoriteti në përmbushje të zbatueshmërisë ligjore
 - 7.1 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve
 - 7.2 Përqasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive
 - 7.3 Mbikëqyrja e përmbushjes së objektivave ligjore për transmetuesit publik
 - 7.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave
 - 7.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje
 8. **AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM**
 - 8.1 Shqyrtimi analitik i përmbajtjeve të emetuara
 - 8.2 Trajtimi i ankesave
 - 8.3 Politika rregulluese për përmbajtjet nga transmetuesit e shërbimit publik
 - 8.4 Monitorimit i përmbajtjeve
 - 8.5 Studio e Monitorimit
 - 8.6 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave
 9. **AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV**
 - 9.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv
 - 9.2 Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv
 - 9.3 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore
10. **DIGJITALIZIMI**
 - 10.1 Angazhim i Autoritetit për përmbushjen e të gjitha hallkave të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike
 - 10.2 Ndërtimi i rrjeteve digjitale të RTSH
 - 10.3 Licencimi i transmetuesve privatë kombëtarë dhe ato me eksperiencë në transmetimet numerike
 - 10.4 Koordinim me RTSH-në për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përbashkëta, lidhur me procesin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike
 - 10.5 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital
 - 10.6 Administrimi i Digjital Dividend 2
 - 10.7 Fushata e informimit të publikut dhe koordinimi me operatorët audiovizivë
11. **AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRIJTJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL**
 - 11.1 Strategjia e komunikimit në kuadër të transparencës
 - 11.2 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore
 - 11.3 Ambientet e punës
12. **TREGUESIT FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE**
 - 12.1 Shfrytëzimi i burimeve të financimit
 - 12.2 Menaxhimi i burimeve financiare
 - 12.3 Pasqyrat financiare
 - 12.4 Treguesit financiar të subjekteve



MISIONI

1.

AMAsi Rregullator ka për mision të sigurojë që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimet fetare, kulturën dhe moralin e qytetarëve, mbështetur në vlerat demokratike të përcaktuara në kushtetutë, veçanërisht në lirinë e shprehjes dhe të medias.

AMA në ushtrimin e funksioneve të veta kujdeset në mënyrë specifike për respektimin e të drejtave, interesave dhe kërkesave morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

VIZIONI

2.

Si Autoritet i pavarur rregullator në fushën audiovizive, AMA angazhohet në shërbim të shoqërisë Shqiptare, duke rregulluar, mbështetur dhe nxitur tregun audioviziv në mënyrë të tillë që shërbimet audiovizive të reflektojnë më së miri vlerat, aspiratat dhe identitetin e shoqërisë Shqiptare.

Në rolin e tij rregullator AMA nxit mënyrat që shërbimet audiovizive të jenë sa më të aksesueshme nga qytetarët nga pikëpamja teknike dhe teknologjike, por dhe sa më të larmishme në përmbajtjet që ofrohen, duke respektuar kërkesat ligjore për paanshmëri në të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut, për të respektuar formimin e lirë të opinionit nga ana e publikut.



PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

3.

Autoriteti, është në angazhim për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe akteve nënligjore dhe si mekanizmi kryesor i ndërveprimit midis ofruesve të shërbimeve audiovizive, publikut, organeve shtetërore veprimtaria dhe zhvillimet në të kanë qenë në vëmendje të shumë aktorëve.

Në vijim të rekomandimeve të lëna AMA, përgjatë 2015 ka vendosur prioritet plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore, i rëndësishëm në përmirësimin e bashkëpunimit me aktorët e tjerë të influencës duke miratuar aktet e nevojshme nënligjore për zhvillimin e procesit të digjitalizimit si dhe ka vijuar punën me procesin e këshillimit publik.

Duke konsideruar autonominë financiare një nga elementet kyç në mirëqeverisjen e Autoritetit, si nga përmirësimi i operativitetit ashtu edhe nga rritja e pavarësisë institucionale, përqendrimi kryesor i veprimtarisë së administratës së AMA-s ishte përmirësimi i shfrytëzimit të burimeve të financimit, vazhdimësisë dhe e angazhimeve të marra nga Autoriteti në fundvitin e 2014 ndaj organizmave mbikqyrës.

Nga realizimi i zërit “Të ardhura nga detyrimet financiare” evidentohet që norma e arkëtueshmërisë të të ardhurave për vitin 2015 është 2 herë më e lartë se mesatarja e normave të arkëtueshmërisë së të ardhurave për vitet 2011-2013. Gjithashtu nga këto të dhëna shihet qartazi trendi i rritjes së normës së arkëtueshmërisë i cili është në koherencë të plotë me angazhimin e Autoritetit në fundvitin e 2014 për rritjen e zbatueshmërisë së ligjit në drejtim të shlyerjes së detyrimeve financiare brenda afateve të përcaktuara.

Në përmbushje të funksioneve ligjore dhe njëkohësisht në ndjekje të rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën për vlerësimin e punës së AMA-s gjatë 2014, përjasja e AMA-s ndaj fenomenit të piraterisë ka qenë pjesë e një plan veprimi i mirë përcaktuar në objektiva dhe afate kohore.

Me strategjinë e komunikimit, janë krijuar linja komunikimi të drejtpërdrejta dhe transparente me subjektet me anë të takimeve konsultative, komunikimeve zyrtare, si dhe vendosjes së pikave të kontaktit për denoncimin e rasteve të piraterisë si dhe është përmirësuar efikasiteti i masave të marra dhe sanksioneve të vëna ndaj subjekteve në shkelje për ndalimin e fenomenit të piraterisë.

Si pasojë gjatë vitit 2015, mes subjekteve audiovizive është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit lidhur me detyrimet që ata kanë në respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave

të autorit, ndërgjegjësim i cili pasqyrohet në dokumentacionin e depozituar prej OSHMA-ve për kalimin e të drejtave të transmetimit të programeve, si dhe dokumentacionin përkatës për përmbushjen e detyrimeve kundrejt agjencive të licencuara të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.

Në aspektin e përmbajtjeve të emetuara nga subjektet audio dhe audiovizive, gjatë vitit 2015 u bë një rishikim i angazhimit të njësive të administratës së AMA me qëllimin kryesor të kalimit nga pozitat e pritmërisë, që bazohej në konceptin e vënies në lëvizje të stafit vetëm pas mbërritjes në institucion të ankesave dhe denoncimeve për programe të ndryshme audio dhe audiovizive, në një qasje proaktive, duke planifikuar dhe realizuar në tematika të caktuara dhe në grupe të caktuara OSHMA-sh shqyrtime analitike, për të nxjerrë në pah konkretisht dhe në mënyrë të detajuar ato probleme dhe shqetësime në programe, si devijime a neglizhime ligjore ose akteve nënligjore në fuqi.

Gjithashtu, në rritje të imazhit institucional të Autoritetit është miratuar programi i transparencës ku përfshihen të gjitha mënyrat dhe format e publikimit të vendimeve të marra, rregullimi i procesit të konsultimit publik, informacionet mbi masat e marra dhe vendosjen e sanksioneve me gjobë, kërkesat rregullatore ndaj OSHMA-ve si dhe llogaridhënien financiare të pasqyrave kontabël të tij.

Gjatë vitit 2015 Autoriteti ka kryer koordinimin me RTSH për përshpejtimin e procesit të implementimit të rrjeteve numerike, vlerësimin e pajtueshmërisë me kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare të transmetimeve audiovizive të miratuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) si dhe nxitja për administrimin dhe përmbushjen e detyrave të përbashkëta, AMA – RTSH, në kuadër të zbatimit të Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike. AMA ka drejtuar koordinimin me operatorët privatë historikë kombëtarë dhe me eksperiencë në transmetimet numerike për rishikimin e kuadrit nënligjor që rregullon procesin e licencimit, i kontestuar në gjykatë gjatë vitit 2013 si dhe përcaktimi i karakteristikave teknike për transmetimet numerike sipas standardeve ndërkombëtare të miratuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU).

Gjithashtu, përfaqësues të AMA-s kanë marrë pjesë aktive në të gjitha mbledhjet e organizuara nga Sekretariati Teknik i cili është ngritur me urdhër të Kryeministrit për mbikëqyrjen e procesit të digjitalizimit të rrjeteve/shërbimeve audiovizive. Në takimet e organizuara AMA ka paraqitur alternativat dhe zgjidhjet e mundshme për përshpejtimin e procesit si dhe ka theksuar problematikat me të cilat është ndeshur në përmbushje të detyrave të saj funksionale, problematika të cilat shkaktonin vonesa të konsiderueshme për përfundimin e këtij procesi. AMA ka ngritur shqetësimin pranë Sekretariatit Teknik lidhur me vonesat e shkaktuara nga RTSH për përcaktimin e fazave të implementimit të rrjetit numerik, përcaktimin e pagesave që duhet të kryejnë subjektet lokale/rajonale të cilët do të mbështeten në rrjetin numerik të RTSH-se si dhe për hartimin e Kontratës së Shërbimit që lidhet midis AMA-s dhe RTSH-së, mbi bazën e të cilës rregullohet veprimtaria e RTSH-së.



AUTORITETI

4.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është Autoriteti Rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, me statusin e personit juridik publik, të pavarur.

Autoriteti përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe pesë anëtarë, ku Kryetari dhe Zëvendëskryetari punojnë pranë AMA-s me kohë të plotë. Aktualisht, Autoriteti operon me 6 anëtarë, pasi një vend anëtar i këshillit vazhdon të mbetet vakant, për shkak të mos zgjedhjes nga parlamenti. Në vijim informacioni në mënyrë të përmbledhur mbi anëtarët e AMA-s, mandatin e tyre dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e vitit 2015.



GENTIAN SALA - Kryetar

Është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2001. Në vitin 2008 kreu studimet Master për “Studime Evropiane” në Universitetin e Tiranës. Që nga viti 2009 - 2014 ka qenë drejtor i projektit “Blej Shqip”, një organizatë jofitimprurëse që merret me promovimin e prodhimeve Shqiptare. Z. Sala ka qenë aktivist prej katër vitesh në Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

Data e fillimit të mandatit	Data e mbarimit të mandatit	Pjesëmarrja në mbledhje
Vendim Nr. 94 datë 06.11.2014	06.11.2019	11/11



SAMI NEZAJ - Zëvendëskryetar

Gazetar me eksperiencë, i angazhuar në pozicione drejtuese në kompani mediatike në vend. Mbajtës i gradës “Doktor Shkencash” në Gazetari nga Universiteti I Tiranës, ku dhe ushtron profesionin e pedagogut për lëndë të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi veprimtarinë audiovizive në Shqipëri. Z. Nezaï është angazhuar në shkrimin e një sërë botimesh e studimesh.

Data e fillimit të mandatit	Data e mbarimit të mandatit	Pjesëmarrja në mbledhje
Vendim Nr. 55, datë 22.07.2010	22.07.2015	1/11



SUELA MUSTA - Anëtar

Gazetare e medias së shkruar dhe vizive, në Shqipëri, e angazhuar gjatë konfliktit etnik në Kosovë si bashkëpunëtore e shumë mediave të huaja evropiane. E diplomuar për gazetari zj. Musta ka qenë korrespondente e Shqipërisë për disa institucione të huaja që në thelb të punës së tyre kanë pasur veprimtarinë audio ose audiovizive. Për disa vite ka mbajtur pozicionet e Zëdhënëses dhe Këshilltares për Marrëdhëniet me Publikun në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Data e fillimit të mandatit	Data e mbarimit të mandatit	Pjesëmarrja në mbledhje
Vendim Nr. 6, datë 05.11.2009	22.07.2015	1/11
Vendim Nr. 55, datë 22.07.2010		



ZYLYFTAR BREGU - Anëtar

Doktor Shkencash në Gazetari dhe Komunikim dhe pedagog prej shumë vitesh në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës. Z. Bregu ka qenë aktivist prej disa vitesh pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit, kohë në të cilën ka kontribuar edhe si specialist i marrëdhënieve me publikun në këtë organizatë.

Data e fillimit të mandatit	Data e mbarimit të mandatit	Pjesëmarrja në mbledhje
Vendim Nr. 54, datë 22.07.2010	22.07.2015	11/11



GLEDIS GJIPALI - Anëtar

I diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, z. Gjipali ka punuar për katër vite në Ministrinë e Integritetit duke u marrë me përafrimin e legjislacionit të BE -së në fushën e të drejtave të njeriut, politikave audiovizuale, dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Prej tetë vitesh drejton organizatën joqeveritare Lëvizja Europiane, aktive në fushën e integritetit europian dhe mirëqeverisjes.

Data e fillimit të mandatit	Data e mbarimit të mandatit	Pjesëmarrja në mbledhje
Vendim Nr.74, datë 09.10.2014	09.10.2019	11/11



PIRO MISHA - Anëtar

Studiues, përkthyes e publicist i njohur shqiptar. Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Dialogut dhe Komunikimit. Ai gjithashtu mban postin e zëvendës-presidentit të Komitetit Ndërqeveritar të Programit të UNESCO “MOST”, Paris. Vlerësuar si një nga dhjetë personalitetet e vitit nga Bashkia Tiranë, për librin “Arratisja nga Burgjet e Historisë”, në vitin 2010. Z. Pisha është autor i disa botimeve në Shqipëri si edhe në Itali, SHBA, Britaninë e Madhe, Belgjikë etj.

Data e fillimit të mandatit	Data e mbarimit të mandatit	Pjesëmarrja në mbledhje
Vendim Nr. 75, datë 09.10.2014	09.10.2019	11/11

Zëvendëskryetari i AMA-s, Z. Sami Nezaj dhe anëtari Zj. Suela Musta, kanë komunikuar mos pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Këshillit të AMA-s, në vijim të deklaratës së bërë më datë 27 nëntor 2014 për shkak të paligjshmërisë, sipas deklaratës së tyre, në procedurat e përzgjedhjes së dy anëtarëve të rinj si dhe të Kryetarit të AMA-s, nga Komisioni për Mjetet e Informimit Publik dhe Edukimit, përkatësisht shkelja e neneve 9 dhe 10 të ligjit 97/2015 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Sa më sipër, në ushtrimin e funksioneve të veta, për gjatë vitit 2015, AMA në 10 mbledhje nga 11 të zhvilluara nuk e ka arritur shumicën e saj të cilësuar pasojë e së cilës ishte pamundësia e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar.

KËSHILLI I ANKESAVE

5.

Struktura e Këshillit të Ankesave u krijua si njësi në strukturën organizative të Autoritetit në përmbushje të kërkesave ligjore për funksionimin e tij. Ai ka për qëllim analizimin e etikës së komunikimit audioviziv, raportet e së drejtës për informim dhe së drejtës për privatësi, për përparësinë e mbrojtjes së interesit publik dhe respektimin e dinjitetit të individit.

Objekt i punës për Këshillin e Ankesave është gjithashtu, mbikëqyrja e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë kryesisht me respektimin e dinjitetit e të drejtave themelore të njeriut, në mënyre të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

Anëtarët e tij caktohen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive me shumicë të cilësuar dhe përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, ndërkohë që Autoriteti ka vijuar punën me përfundimin e procesit të rekrutimit sipas kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme të përcaktuara me Vendim të AMA-s Nr. 30, datë 16.04.2015.





QEVERISJA E AUTORITETIT DHE ZHVILLIMET ORGANIZATIVE

6.

Autoriteti, si institucion rregullator në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, është në angazhim për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe akteve nënligjore, të cilat garantojnë një treg të qëndrueshëm, të shumëllojshëm, në plotësim të nevojave të qytetarëve për t'u informuar.

Roli i aktivitetit rregullues është i rëndësishëm si për dizenjimin e politikave të duhura ashtu edhe për ekzekutimin e tyre duke qenë mekanizmi kryesor i ndërveprimit midis ofruesve të shërbimeve audiovizive, publikut, organeve shtetërore dhe aktoreve të tjerë kombëtare dhe ndërkombëtare. Qeverisja e Autoritetit dhe zhvillimet në të kanë qenë në vëmendje të shumë aktorëve në shoqërinë shqiptare konsideruar rolin e tij të pavarur të cilin ai duhet të ketë në tregun audioviziv.

Si nga rekomandimet e lëna në Rezolutën për Vlerësimin e Veprimtarisë së AMA-s nga Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2014 ashtu edhe nga rekomandimet e lëna në Progres Raportin për Shqipërinë, nga AMA pretendohet ushtrimi i plotë i funksioneve të tij në përmbushje të rolit të tij si rregullator i pavarur.

Efektiviteti në përmbushjen e objektivave të Autoritetit, është mbi të gjitha benefit i shoqërisë në tërësi, i materializuar ky në të gjitha format e influencës që veprimtaria medias audiovizive ka në publikun e gjerë.

Të vetë dijshtëm për këtë rol, Autoriteti, është angazhuar në përmirësimin e elementeve të identifikuar në shqyrtimin e qeverisjes së rregullatorit, referuar Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) dhe aplikuar nga rregullatorët audioviziv të vendeve evropiane (Raporti i Grupit Rregullator Evropian të Shërbimeve Audiovizuale (ERGA), mbi pavarësinë e Autoriteteve Rregullatorë Nacionale/ Dhjetor 2015) të cilët janë si më poshtë vijon:

- Kuadri Institucional
- Procedurat e emërimit dhe mandati
- Burimet Njerëzore
- Autonomia Financiare
- Llogaridhënia dhe Transparenca
- Vendimarrja
- Zbatueshmëria e vendimarrjes

Në realitetin e AMA-s, në vitin raportues, elementet si Kuadri Institucional, Vendimmarrja dhe Zbatueshmëria e Vendimmarrjes janë tashmë të rregulluara dhe të përcaktuara në ligjin për mediat, i cili është i përafuar plotësisht me direktivat evropiane duke siguruar kështu pavarësi institucionale të Autoritetit në qeverisjen e tij. Për rrjedhojë, shqyrtimi i tyre nuk pasqyron zhvillime të mëtejshme në periudhën aktuale.

Për sa i përket elementeve të tjerë shqyrtimi i tyre është pasqyruar në këto zhvillime:

- Nga shqyrtimi i elementit të dytë, “Procedurat e Emërimit dhe Mandate” - edhe përgjatë vitit 2015 AMA nuk ka funksionuar në përbërjen e tij të plotë, rezultat i të cilit kanë qenë:
 - pamundësi në vendimmarrje ku kërkohet shumicë e cilësuar
 - mos respektim të afateve të strategjive kombëtare
 - pamundësi realizimi të proceseve ku kërkohet funksionimi i plotë i AMA, referuar kryesisht procesit të digjitalizimit
 - rekrutimi i këshillit të ankesave
 - pamundësi në dhënien e licencave e shoqëruar kjo me kosto të larta financiare për Autoritetin

Nga AMA ka pasur njoftime dhe korrespondence të vazhdueshme me Komisionin e Mjeteve të Informimit Publik dhe Edukimit por edhe me Kuvendin e Shqipërisë, për zgjidhjen e këtij ngërçi institucional.

- Në shqyrtimin e elementit “Burimet Njerëzore” ku përfshihet aftësia e rregullatorit në menaxhimin e burimeve njerëzore, organizimin e proceseve sipas strukturës organizative, AMA është angazhuar përgjatë gjithë gjashtëmujorit të fundit të 2015.

Me skanimin e të gjitha funksioneve të AMA-s si detyrime për t’u përmbushur nga ligji mbi median audiovizive u konkludua që struktura aktuale e administratës së AMA-s ishte inefficente në mbulimin e tyre. Disa nga funksionet kryesore të AMA si mbikëqyrja e tregut audioviziv, nxitja dhe promovimi i zhvillimit të sektorit audioviziv, informimi mbi të dhënat e tregut si dhe vetë menaxhimi i burimeve njerëzore të administratës së AMA nuk mbulohen nga njësi e caktuar në strukturën aktuale.

Ligji për mediat audiovizive në fuqi përcakton në mënyrë specifike funksionet dhe objektivat e AMA-s të cilat duhet të reflektohen në organizimin e brendshëm nëpërmjet strukturës organizative dhe qartësimit të roleve për çdo drejtori.

Në muajin dhjetor, në mbledhjen e saj të fundit, AMA diskutoi projekt rregulloren e brendshme për strukturën e re organizative. Këto ndryshime të propozuara, kanë si qëllim pasjen e një strukture efikente për të menaxhuar, zgjidhur dhe përgjigjur sa më mirë funksioneve dhe detyrimeve të përcaktuara për AMA-n në Ligjin 97/2013.

Projekt rregullorja e brendshme për strukturën organizative të AMA-s, u miratua nga Këshilli i AMA-s dhe i është paraqitur Kuvendit dhe Komisionit të Mjeteve të Informimit Publik dhe

Edukimit për miratim gjatë muajit shkurt 2016. Menaxhimi i proceseve dhe i burimeve në përmbushje të plotë të detyrave funksionale të AMA-s është një faktor që do të përmirësojë dukshëm qeverisjen e tij edhe përgjatë vitit 2016.

- Në shqyrtimin e “Autonomisë Financiare”, Autoriteti edhe pse ka dyfishuar normën e arkëtueshmërisë të të ardhurave financiare për vitin 2015 krahasuar me normën mesatare të viteve të fundit, vazhdon të hasë vështirësi financiare në mbulimin e investimeve të kërkuara në përmirësim të kapaciteteve teknike.

Konkretisht investimi në mjetet logjistike, të kërkuara për ushtrimin e plotë të funksionit monitorues të Autoritetit, është një zë i cili parashikohet të mbulohet nga financime të donatorëve, për shkak të pamundësisë financiare të institucionit në mbulimin e tij. AMA është angazhuar në komunikime të vazhdueshme me organizmat ndërkombëtarë dhe me Ministrinë e Integritit Evropian, përgjegjëse për alokimin e fondeve IPA, që gjetja e mënyrave të suksesshme për mbulimin e këtij zëri të rëndësishëm të marri vëmendjen dhe zgjidhjen e duhur, por pavarësisht gjithçka u përmend ky zë mbetet ende i pambuluar edhe në periudhën aktuale.

Një zë tjetër i cili cenon autonominë financiare të autoritetit është edhe ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve për detyrimet financiare të përcaktuara nga gjyqet për dëme të shkaktuara në periudhat e mëparshme. AMA ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Financave për adresimin dhe zgjidhjen e këtij problemi, por edhe në këtë rast për vitin 2016 ende nuk është dhënë një alternativë zgjidhjeje për mbulimin e këtij zëri.

Autoriteti në mënyrë që të operojë brenda kapaciteteve të tij financiare duke gëzuar një autonomi të kënaqshme në mbulimin e veprimtarisë së tij të përditshme përgjatë 2016 synon të fokusohet në gjetjen e mënyrave të suksesshme për mbulimin e zërave të mësipërm.

- Për elementin e “Llogaridhënies dhe Transparencës” AMA në zbatim të detyrimeve të saj ligjore, mbi konfliktin e interesave, ka miratuar, Kodin e Etikës të Punonjësve të Administratës së AMA-s dhe gjithashtu, ka hartuar Projekt Kodin e Sjelljes së AMA-s, i cili është në proces miratimi dhe synon të përcaktojë procedurat dhe parimet e përmbledhura me dispozitat e ligjit nr. 97/2013 si dhe parimeve që zbatohen dhe udhëheqin veprimtarinë e anëtarësisë, zëvendëskryetarit dhe kryetarit të AMA, gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksioneve, që u njeh ligji.

Në vijim të shqyrtimit të këtij elementi, AMA ka miratuar programin e transparencës ku përfshihen edhe të gjitha mënyrat dhe format e publikimit të vendimeve të marra, rregullimi i procesit të konsultimit publik, informacionet mbi masat e marra dhe vendosjen e sanksioneve me gjobë, kërkesat rregullatore ndaj OSHMA-ve si dhe llogaridhënien financiare të pasqyrave kontabël të tij. Ky program transparence është në përputhje të plotë me ligjin mbi të drejtën e informimit, dhe rrit dukshëm imazhin institucional duke përmirësuar qeverisjen e Autoritetit.



AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE

7.

7.1 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve

AMA, përgjatë 2015 ka vendosur prioritet finalizimin e përcaktimit të detyrimeve, funksioneve, ndërveprimin dhe koordinimin midis njësive brenda Autoritetit si dhe me organizmat jashtë tij. Plotësimi i kuadrit ligjor me këto akte nënligjore është i rëndësishëm jo vetëm për efektivitetin e punës brenda autoritetit, por edhe në përmirësimin e bashkëpunimit me aktoret e tjerë të influencës.

Pavarësisht konturimit të qartë të aktivitetit rregullator të Autoritetit, nga ligji për mediat, natyra komplekse dhe shumë dimensionale e tij nga një anë dhe burimet e limituara financiare dhe njerëzore nga ana tjetër sjellin domosdoshmërinë e përcaktimit të fokusit dhe prioritetëve kryesore të këtij aktiviteti në një strategji afatmesme.

Dinamika dhe kompleksiteti i ambientit që Autoriteti rregullon përfshin garantimin e një sërë të drejtash dhe lirive të cilat janë në fokus të shumë organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare. Krijimi i një partneriteti për rritjen e sinergjisë në përmbushjen e objektivave të përbashkëta e materializuar kjo në draftimin strategjisë afatmesme (ndër të tjera detyrim ligjor i parashikuar në nenin 21 të ligjit mbi mediat audiovizive nr. 97/2013), ishte angazhimi prioritar i AMA-s i që aktualisht është duke u materializuar në formalizmin e një marrëdhënie asistencë me Këshillin e Evropës, nëpërmjet edhe diskutimeve të përbashkëta me Përfaqësinë e Delegacionin Evropian në Shqipëri.

AMA ka inkurajuar ngritjen e rrjetit të partneritetit:

- në kuadrin e asistencës teknike-profesionale për:
 - Hartimin e politikave që sigurojnë respektimin e larmisë së traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve që të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve;
 - Hartimin e politikave nxitëse për zhvillimin e shërbimeve të transmetimit dhe programeve në gjuhën shqipe;
- kontributit të aktorëve në fushat me interes të përbashkët, kryesisht por pa u kufizuar në:
 - Identifikimin dhe zbatimin e akteve rregullative, marrëveshjeve, apo mekanizma

të tjerë rregullues që bëjnë të mundur sigurimin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të programeve dhe me risi nga OSHMA-të publike e private si dhe promovimin e programeve të shumëllojshme dhe pa pagesë;

- Identifikimin e mekanizmave që nxisin realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri dhe që është i përgjegjshëm për nevojat e dëgjuesve e shikuesve dhe në veçanti për personat me nevoja të veçanta shqisore;
- kontributit të aktoreve në fushat me interes të përbashkët për rritjen e impaktit për rritjen e cilësisë së përmbajtjeve/transmetimeve të operatorit publik kryesisht në:
 - Hartimin e politikave që bëjnë të mundur sigurimin e përmbushjes së objektivave nga transmetuesit e shërbimit publik, sipas përcaktimeve ligjore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me RTSH-në;

Gjatë gjithë vitit raportues AMA ka qenë e angazhuar në hartimin e akteve të nevojshme rregullatore, një pjesë e të cilave tashmë janë miratuar. Ndër to përmendim akte me ndikim të drejtpërdrejtë, si:

- Akt i Brendshëm “Mbi procedurat e rinovimit të licencave të operatorëve privatë audio dhe audiovizivë, të licencuar sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” miratuar me vendimin nr. 2, datë 04.02.2015 të AMA-s.
- Vendimi nr. 28, datë 16.04.2015 “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së beauty contest”. Bazuar në këtë akt, AMA, miratoi edhe vendimin nr. 29, datë 16.04.2015 “Për çeljen e procedurës së dhënies së 5 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik, sipas beauty contest”.
- Rregullorja “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve” miratuar me vendimin nr. 56, datë 10.07.2015 të AMA-s. Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv dhe licencës së shërbimit të programit audioviziv.

Gjatë 2015, është punuar edhe për hartimin e projekt-rregulloreve të mëposhtme, disa prej të cilave janë në proces hartimi ose në procesin e këshillimit publik.

Nr.	Projekt Rregulloret	Objekti	Statusi
1	“Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”	Kjo projekt-rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së transmetimit audio dhe licencës së shërbimit të programit audio. Në të parashikohen rregullat, kriteret dhe kërkesat juridike, financiare, programore dhe teknike që duhet të respektohen nga subjektet, që do të aplikojnë për t’u pajisur me licencë kombëtare/rajonale/lokale transmetimi audio.	Ka përfunduar këshillimi publik. Në proces shqyrtimi nga këshilli i AMA-s.
2	“Për transmetimin pa shpërblim të mesazheve me interes të lartë për publikun e gjerë”	Kjo projekt-rregullore përcakton transmetimin e mesazheve pa shpërblim nga OSHMA-të. Në këtë mënyrë detajohen dhe qartësohen ato raste kur ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv duhet “të lëshojnë” hapësirat e tyre për emetimin pa pagesë të përmbajtjeve nga organet e pushtetit qendror dhe vendor që konsiderohen me interes të lartë për audiencën dhe bëhen pa pagesë, si në rastet kur këto njoftime ndikojnë në mbrojtjen e shëndetit publik, bëhen për fatkeqësitë natyrore, për cenimin e rendit publik, sigurisë kombëtare etj.	Ka përfunduar këshillimi publik. Në proces shqyrtimi nga këshilli i AMA-s.
3	“Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit”	Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit.	Ka përfunduar këshillimi publik.

7.2 Përqasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive

Në përmbushje të funksioneve ligjore dhe njëkohësisht në ndjekje të rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën për vlerësimin e punës së AMA-s gjatë 2014, përqasja e AMA-s ndaj fenomenit të piraterisë ka qenë pjesë e një plan veprimi i mirëpërcaktuar në objektiva dhe afate kohore. Pjesë integrale e këtij plani veprimi për 2015 ka qenë:

- Strategjia e komunikimit, duke krijuar linja komunikimi të drejtpërdrejta dhe transparente me subjektet me anë të takimeve konsultative, komunikimeve zyrtare, si dhe vendosjes së pikave të kontaktit për denoncimin e rasteve të piraterisë;
- Përzgjedhjen e personelit të dedikuar për kryerjen e funksioneve inspektuese në rastet ankmuara për pirateri duke u fokusuar njëkohësisht në trajnimin e vazhdueshëm të tyre dhe përmirësimin e mjeteve logjistike në përdorim për një mbulim sa më të mirë në kohë dhe në hapësirë;
- Angazhimin në marrëdhënie bashkëpunimi me organet kompetente si për mundësimin e trajtimit të rasteve problematike gjatë inspektimeve me Policinë e Shtetit ashtu dhe në koordinimin e aksioneve me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet debitor që rezultojnë problematike;
- Përmirësimin dhe plotësimin e akteve rregullative në rritje të efikasitetit të masave të marra dhe sanksioneve të vëna ndaj subjekteve në shkelje për ndalimin e fenomenit të piraterisë.

Si, pasojë e kësaj strategjie komunikimi eficiente, gjatë periudhës raportuese në AMA janë depozituar një sërë ankesash për mosrespektimin e të drejtave të transmetimit/autorit nga subjekte të licencuar/autorizuar ose jo, si dhe nga subjekte të tjerë të interesuar. Konkretisht rezulton se për vitin 2015 në AMA janë adresuar ankesat e dokumentuara si më poshtë:

- 129 ankesa të depozituara nga platforma numerike satelitore;
- 22 ankesa të depozituara nga subjektet kablllore;
- 8 ankesa të depozituara nga subjekte të tjerë të interesuar, tre prej të cilave ndaj RTSH-së;
- 4 ankesa të depozituara nga agjencitë e administrimit kolektiv;
- 1 ankesë e depozituar nga RTSH për eventin sportiv të UEFA 2015;

Stafi i administratës së AMA-s ka ndjekur me prioritet të gjitha ankesat për pirateri të depozituara pranë autoritetit, duke kryer inspektimet në terren apo monitorimet rast pas rasti. Në përfundim të procedurave përkatëse administrative, janë sanksionuar me gjobë subjektet, për mos respektimin e të drejtave të transmetimit si dhe ndalimin e hyrjes së inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet audiovizive të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara prej tyre.

Gjithsej gjatë vitit 2015 janë kryer 114 inspektime, nga të cilat janë marre masat e mëposhtme:

- 46 masa me dënim administrativ me gjobë (10 janë shfuqizuar nga Këshilli i Ama-s; 2 sanksione për t'u shqyrtuar në mbledhjen e radhës)
- 30 tërheqje vëmendje
- 29 Mos-fillim hetimi pasi nuk ka pasur shkak ligjor.
- 9 masa administrative me sekuestrim të pajisjeve audiovizive për aktivitet të kundërligjshëm.

Në përmbushje të programit të transparencës në faqen online të AMA, www.ama.gov.al në rubrikën përkatëse të transparencës gjendet informacioni i përditësuar mbi informacionin e masave administrative të marra, direkt i aksesueshëm në linkun Pasqyra-e-Sanksioneve-Gjobe-për-vitin-2015-2016.pdf

Gjithashtu, për sa i përket subjekteve të palicencuar/paaautorizuar, gjatë vitit 2015, AMA ka ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme një numër të konsiderueshëm aksionesh për ndalimin e gjendjes së informalitetit në të cilin disa subjekte ushtronin aktivitet audioviziv.

7.3 Mbikëqyrja e përmbushjes së objektivave ligjore për transmetuesit publik

Funksioni dhe detyrim ligjor, i AMA-s është edhe mbikëqyrja e përmbushjes së objektivave të përcaktuara në ligj për transmetuesin publik (RTSH).

Ndër objektivat kryesorë të RTSH-së për vitin 2015 ka qenë ndërtimi i rrjeteve kombëtare numerike. Në përmbushje të këtij objektiv AMA ka qenë gjithmonë nxitëse për përshpejtimin e procesit në koordinimin e bashkëpunimit midis RTSH-së dhe MIAP, për adresimin e një sërë çështjeve të rëndësishme si përcaktimi i afateve të implementimit të rrjeteve, përcaktimi i pagesës që duhet të kryejnë subjektet lokale/rajonale, përcaktimi i vendndodhjes së pikave të lidhjes midis RTSH-së dhe subjekteve lokale/rajonale si dhe çështje të tjera teknike. AMA ka kryer monitorime të vazhdueshme për të kontrolluar shfrytëzimin e spektrit të frekuencave dhënë në përdorim RTSH-së për ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive analoge si dhe cilësinë e transmetimit.

Objektiv i vendosur në ligj për RTSH-në është edhe hartimi i kontratës së shërbimit që lidhet midis AMA-s dhe RTSH-së, ku përfshihen ndër të tjera edhe kriteret lidhur me pagesën që duhet të kryejnë subjektet lokale/rajonale ndaj RTSH-së si dhe kriteret teknike që lidhen me fazat e implementimit të projektit të RTSH-së.

AMA ka qenë dhe mbetet në kërkesën thelbësore, që është dhe detyrim i ligjit 97/2013

për zhvillimin e konsultimit publik nga transmetuesi publik, para se teksti i kontratës së shërbimit të paraqitet për miratim nga Autoriteti. Në politikën e hartuar nga AMA janë përcaktuar mënyrat dhe rrugët që duhet të ndjekë operatori publik për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara ndaj tij në bazë të ligjit dhe Kontratës së Shërbimit.

Një aspekt i rëndësishëm ku kërkohet rregullimi në këtë marrëdhënie me RTSH-në është programacioni për fëmijët, përmbajtje që përcjellin e të kultivojnë vlera të larta qytetare e humane, që promovojnë modele referimi femra e meshkuj, në respekt të dinjitetit, barazisë gjinore, diversitetit, traditës, gjuhës e kulturës shqiptare.

Transmetuesi publik duhet të përmbush detyrimet, jo vetëm në sasi, duke programuar jo më pak se 10% të kohës së transmetimit për fëmijët, por dhe ideimi dhe realizimi i emisioneve, rubrikave dhe kronikave të marrë në konsideratë dhe format ndërvepruese të komunikimit, të konvergjencës së emetimit klasik me atë online, në bashkëveprim me mediat sociale etj.

RTSH, me kalimin në transmetimet numerike, do të duhet të ketë të paktën, një kanal të dedikuar fëmijëve, dhe programe për fëmijë, në fasha orare të programuara vetëm për këtë qëllim. Në fashën orare 7:00 deri në 22:30 e prezumuar për shikim familjar, në të gjitha llojet e programeve që do të transmetohen nga RTSH do të mbikëqyret mbajtja parasysh e shëndetit mendor e fizik të fëmijëve e adoleshentëve, ndjeshmëritë e kërkesat e tyre, sidomos në programet informative dhe filmat e programet argëtuese, por dhe të nxisin pjesëmarrjen e fëmijëve në median audiovizive, sensin kritik, iniciativat dhe projektet e tyre në dobi të shoqërisë e të vetëformimit të fëmijëve.

Lidhur me përcaktimin e kriterëve dhe masave rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së, AMA ka hartuar rregulloren përkatëse e cila pritët të kalojë në fazën e konsultimit publik.

Në këtë rregullore janë përcaktuar të drejta dhe detyrime për subjektet e licencuar nga AMA lidhur me përdorimin e infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive.

7.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Bazuar në ligjin 97/2013, kuadrin rregullator dhe rekomandimet ndërkombëtare (ITU, CEPT), AMA ka kryer monitorimin e spektrit të frekuencave audio/audiovizive, në pikat në të cilat transmetojnë subjektet audio/audiovizive. Monitorimi kryhet për spektrin e frekuencave 174 – 230 MHz dhe 470-862 MHz për shërbimet audiovizive dhe 88-108 MHz për shërbimet audio.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit janë kryer monitorime në të gjitha pikat e transmetimit që ndodhen në qarqet Tiranë, Fier, Korçë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Lezhë, Shkodër dhe në gjashtëmujorin e dytë, në pikat e transmetimit në të gjithë qarqet e vendit. Këto monitorime janë kryer nga më shumë se një fushëpamje për çdo pikë transmetuese, në mënyrë që rezultatet të jenë sa më të sakta. Monitorimi konsiston në kontrollin e shfrytëzimit të spektrit që i është dhënë në përdorim subjekteve audio/audiovizive të licencuar nga AMA. Konkretisht, gjatë aktivitetit monitorues verifikohet:

- Nëse subjektet e licencuar janë në transmetim;
- Nëse subjektet të cilëve iu është hequr licenca nuk gjenden në transmetim;
- Niveli i sinjalit i cili përcakton cilësinë e transmetimit;
- Subjektet që transmetojnë në mënyrë të paligjshme.

Përqindja e mbulimit me sinjal përlllogaritët nëpërmjet sistemit informatik profesional ICS Telecom, të rekomanduar nga ITU, bazuar në të dhënat teknike të përcaktuara në licencë. Problematikat kryesore të konstatuara nga monitorimet lidhen me moszbatimin e kushteve teknike të transmetimit të përcaktuara në licence. Bazuar në monitorimet e kryera shkeljet e konstatuara kanë qenë si më poshtë:

- Subjekte të cilët transmetojnë edhe pse i është hequr licenca nga AMA. Janë konstatuar 4 subjekte radio, 2 prej të cilëve u janë bllokuar pajisjet ndërsa 2 të tjerët janë sanksionuar me gjobë dhe kanë mbyllur menjëherë transmetimin.
- Subjektet që nuk kanë dalë në transmetim brenda afateve të përcaktuara në ligj dhe aktet rregullatore. Lidhur me këto subjekte AMA ka filluar procedurën për heqjen e licencës
- Subjektet nuk mbulojnë me shërbim zonën për të cilën janë licencuar. Këta subjekte janë njoftuar për reduktimin e zonës së shërbimit brenda afateve të përcaktuara, shkelja e të cilave do pasonte me sanksionet e parashikuara nga dispozitat ligjore.
- Subjekte të cilët transmetojnë jashtë zonës së licencimit (kanë zgjeruar zonën e licencimit pa miratimin e AMA-s). Lidhur me subjektet audio (radio FM) janë njoftuar zyrtarisht këta subjekte për mbylljen e transmetimeve brenda afateve të përcaktuara nga AMA shkelja e të cilave do pasonte vendosjen e sanksioneve. Për sa i përket subjekteve audiovizive (televizioneve), si për ato që transmetojnë në analog ashtu edhe ato që transmetojnë në teknologjinë digjitale, Autoriteti është fokusuar në përfundimin e procesit të digjitalizimit i cili është faktori kyç për zgjidhjen përfundimtare të situatës.
- Subjekte që kanë pasur ndërprerje transmetimi mbi 30 ditë në vit. Lidhur me subjektet e licencuar të cilët nuk janë gjetur në transmetim janë vendosur

korrespondenca me subjektet për ndërprerjet e transmetimit dhe është bërë ndjekja e tyre deri në adresimin e duhur të problemeve.

- Janë konstatuar raste kur parametrat teknike të sinjalit të transmetimit nuk kanë qenë brenda standardeve teknike ndërkombëtare, kjo sidomos në disa zona rurale të vendit. Në këto raste AMA u është drejtuar me shkresë subjekteve ku i kërkon përmirësimin e parametrave teknike të transmetimit.

Nga monitorimet e kryera gjatë vitit 2015, janë konstatuar operatorë audiovizivë që nuk kanë respektuar zonën e mbulimit të përcaktuar në kushtet e licencës. Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2015, disa operatorë vendorë vazhdojnë të transmetojnë në teknologji numerike. Duke konsideruar dispozitat ligjore, që përcaktojnë kalimin e transmetimeve analoge në ato numerike brenda datës 17 Qershor të vitit të raportuar, AMA ka ndjekur politika lehtësuese ndaj këtyre operatorëve audiovizive duke iu referuar ecures së procesit të digjitalizimit, i cili hasi pengesa në përfundimin e tij si rrjedhojë e vonësave në procesin e implementimit të rrjeteve numerike të RTSH si dhe bllokimit të procesit të licencimit të operatorëve privatë kombëtarë dhe me eksperiencë në transmetimet numerike.

Edhe gjatë vitit 2016 në fokusin e AMA-s do të mbetet mbikëqyrja, konstatimi i shkeljeve dhe marrja e masave administrative për të gjithë subjektet audio/audiovizive që nuk zbatojnë ligjin, aktet rregullatore dhe kushtet e përcaktuara në licencë. Gjithashtu në përmirësim të logjistikës së përdorur gjatë vitit 2015 janë prokuruar pajisje teknike për të kryer monitorimin e spektrit të frekuencave edhe në zona të thella (pajisje portabile) duke përmirësuar ndjeshëm procesin e monitorimit veçanërisht në identifikimin e subjekteve të palicencuar të cilët transmetojnë në numerik në standardin DVB-T2, MPEG-4.

7.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje

Fokus i Autoritetit gjatë vitit 2015 kanë qenë adresimi i i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje nga subjektet që ofrojnë shërbime audiovizive në vendin tonë, në brezin 790-862 MHz, i njohur si brezi i dividendit digjital.

Ankesat për interferencë janë paraqitur nga Mali i Zi dhe Italia. AMA i ka trajtuar me prioritet duke monitoruar përdorimin e brezit DD1 dhe në bashkëpunim me administratat e vendeve fqinje janë identifikuar burimet e interferencës. Ndërkohë interferencat me vendet fqinje vijnë të shkaktohen nga subjektet të cilët transmetojnë në brezin DD1 transmetime audiovizive numerike dhe subjektet e licencuar nga AMA për të transmetuar në këtë brez në analog.

Duke konsideruar si zgjidhjen përfundimtare të interferencave përfundimin e procesit të digjitalizimit AMA e ka ngritur shqetësimin e saj për vonesat e procesit të digjitalizimit në çdo takim dhe konferencë të organizuar si dhe në korrespondenca shkresore me institucionet dhe palët përgjegjëse.

Ankesa për interferencë janë paraqitur nga vendet fqinje (Maqedonia dhe Kroacia) lidhur me shqetësimet që shkaktoheshin në brezin e navigacionit ajror të vendeve fqinje nga subjektet tona audio/audiovizive AMA, për monitorimin e frekuencave, bashkëpunon me AKEP-in dhe me institucionet e tjera, të ngarkuara për administrimin e spektrit të frekuencave.

Gjatë vitit 2015 është bashkëpunuar me AKEP për shmangien e interferencave që shkaktoheshin në brezin e frekuencave të shërbimit aeronautik në vendin tonë dhe në vendet fqinje, nga subjektet audio dhe audiovizive. Në kuadër të bashkëpunimit janë ngritur grupe të përbashkëta monitorimi për identifikimin dhe analizimin e interferencave të shkaktuara dhe në përfundim është arritur shmangia e interferencave brenda afateve kohore minimale.



AUTORITETI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

8.

8.1 Shqyrtimi analitik i përmbajtjeve të emetuara

Për të përmbushur funksionet dhe detyrimet sipas ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit në aspektin e përmbajtjeve të emetuara nga subjektet audio dhe audiovizive, gjatë vitit 2015 u bë një rishikim i angazhimit të Drejtorisë së Programeve, me qëllimin kryesor të kalimit nga pozitat e pritmërisë, që bazohej në konceptin e vënies në lëvizje të stafit vetëm pas mbërritjes në institucion të ankesave dhe denoncimeve për programe të ndryshme audio dhe audiovizive, në një qasje proaktive, duke planifikuar dhe realizuar në tematika të caktuara dhe në grupe të caktuara OSHMA-sh shqyrtime analitike, për të nxjerrë në pah konkretisht dhe në mënyrë të detajuar ato probleme dhe shqetësime në programe, si devijanca a neglizhime ligjore ose akteve nënligjore në fuqi.

Në muajt mars dhe prill 2015 u bë një shqyrtim analitik, duke pasur si fokus programacionet për fëmijët në tre subjektet televizive kombëtare (TVSH, Top Channel e Klan) si dhe Vizion Plus. Specialistët e programacionit monitoruan dhe analizuan performancën e redaksive të këtyre televizioneve, me mjaft ndikim në publik, duke evidentuar disa probleme thelbësore me transmetimet për të miturit, si:

- Mungesën e programeve të prodhuara nga vetë televizionet;
- Përqendrimin vetëm tek filma apo emisione zbavitëse e argëtuese të përkthyer dhe të viteve më parë;
- Pakujdesinë në disa raste të shfaqjes në ekran të fëmijëve, duke mos respektuar Kodin e Transmetimit për mbrojtjen e tyre;
- Parregullsi në vendosjen e shenjave paralajmëruese në transmetimin e filmave dhe programeve me përmbajtje të dhunshme, pornografike etj.

Problematikat e konstatuara kanë qenë pjesë e vazhdueshme e komunikimeve, takimeve me grupet e interesit dhe e qëndrimeve të Autoritetit për adresimin e trajtimit të tyre. Por kjo qasje e re e Drejtorisë së Programeve kërkonte dhe një riformatim të kësaj strukturë, në mënyrë që dhe burimet njerëzore të ishin në përshtatje me detyrat e ngarkuara, si dhe profilizimin e punës në disa prej aspekteve kryesore në programacion.

Me përfundimin e këtij riformatimi, u realizua në tremujorin e katërt të vitit 2015 shqyrtimi i parë analitik, i përqendruar tek një nga çështjet më problematike të transmetimeve audiovizive, reklamave dhe komunikimet tregtare. Në fokus ishin tre televizionet kombëtare, TVSH, Klan dhe Top Channel. Në përgjithësi problemet më të hasura në transmetimet e reklamave ishin:

- kohëzgjatja e tyre të transmetuara brenda 1 ore, duke tejkaluar 12 minutëshin, në kundërshtim me nenin 41 pika 1 të ligjit 97/2013;
- evidentuar raste të transmetimit të reklamave me ekran të ndarë në mënyrë të pandërprerë, në kundërshtim me nenin 38 pika 3 po të këtij ligji;
- keqpërdorim i “Vendosjes së Produktit” në programe, duke nxitur drejtpërdrejt marrjen ose përdorimin e mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht duke bërë përmendje të posaçme promovionale të këtyre mallrave dhe shërbimeve, si dhe duke i kushtuar vëmendje të tepruar, në kundërshtim me nenin 44 pika 3 germa (b) dhe (c) po të ligjit 97/2013;
- transmetim të komunikimeve me natyrë tregtare të fshehtë, në kundërshtim me nenin 42 pika 1 të ligjit;
- transmetim të reklamave të papërshtatshme sa i përket përmbajtjes së tyre, në kundërshtim me nenin 4 pika 1 germa (b), nenin 33 pika 1 germa (d), nenin 46 pika 2 germa (c) dhe (dh) të ligjit 97/2013;
- transmetimit të reklamave në gjuhë të huaj, në kundërshtim me nenin 4 pika 2 germa (b) të ligjit.

Përveç tre subjekteve kombëtare në një fazë vijuese për fillimin e vitit 2016 në fokus të shqyrtimit analitik po për transmetimin e reklamave janë info televizionet, të cilat kanë specifika në konceptimin dhe shitjen e kohës për reklamimin e subjekteve të interesuara.

Faza tjetër e rëndësishme e procesit të shqyrtimit analitik të përmbajtjeve të mësipërme ishte komunikimi me subjektet audiovizive, ndërgjegjësimi për respektimin e kërkesave ligjore, si një formë paralajmërimi për rastet e përsëritjeve të problematikave të tilla.

8.2 Trajtimi i ankesave

Një ndër risitë në strategjinë e Autoritetit ka qenë dhe vendosja e një kanali të ri komunikimi me publikun, nëpërmjet adresës së dedikuar elektronike e institucionit. Përmes saj kanë mbërritur rreth 30 ankesa vetëm për përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të kombëtare ose lokale. Ankesat për probleme të përmbajtjeve të emetuara kanë ardhur nga individë, nga institucione, apo nga vetë brenda tregut audioviziv, si ankesa të subjekteve për subjektet.

Rreth 60% e tyre lidheshin me filma me përmbajtje të dhunshme dhe pornografikë në orare të papërshtatshme. Pjesa tjetër ishte për identifikimin e fëmijëve në kronika ose emisione, në kundërshtim me kërkesat e ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit, si dhe për probleme të etikës dhe gjuhës së përdorur në emisione.

Të gjitha ankesat kanë marrë përgjigje nga institucioni, duke informuar mbi procedimin që kishte bërë AMA për rastet konkrete që janë raportuar në njoftimet zyrtare. Në vijim informacioni kronologjik mbi tërheqjet e vëmendjes të dokumentuara të Autoritetit ndaj subjekteve në adresimin e rasteve të ankimuara.

8.3 Politika rregulluese për përmbajtjet nga transmetuesit e shërbimit publik

Në rolin e tij rregullator në lidhje me programacionin, AMA ka përcaktuar në politikën e saj të hartuar në vitin 2015 ngritjen e një sistemi vlerësimi e monitorimi të përmbajtjeve, vlerave e cilësisë, duke i dhënë përparësi qasjes dhe interesave të publikut, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës programore.

Zbatimin e kësaj metodologjie mbikëqyrëse AMA e shikon si kombinim i shqyrtimeve tematike të planifikuara nga ana e Drejtorisë së Programeve, duke u fokusuar në aspekte të veçanta të përmbajtjeve informuese, edukuese, argëtuese, reklamuese etj., me ndjekjen në mënyrë rigoroze të të gjitha ankesave e vërejtjeve që mbërrijnë në adresë të transmetuesit publik, duke verifikuar përputhshmërinë ligjore, mbi të gjitha të ballafaquara me kushtet dhe angazhimet e vetë RTSH-së në kontratën e shërbimit të miratuar.

Në përputhje me këtë politikë, oferta programore e RTSH-së duhet të konsiderojë gjithnjë detyrimin për të krijuar të qytetarët një perceptim pozitiv për shërbimin e transmetuesit publik, edhe për shkak të taksës së abonimit, të receptimit të përmbushjes së misionit në dobi të interesave të publikut, për të cilin është krijuar dhe funksionon radiotelevizioni publik.

Produkti audioviziv i RTSH-së është objekt monitorimi nga AMA dhe për aspektin e promovimit dhe mbrojtjes së gjuhës shqipe, kulturës letrare gjuhësore, drejtshkrimin e drejtshqiptimit e saj. Që këtë buron detyrimi për programe të veçanta për rolin dhe rëndësinë e gjuhës shqipe, historinë, zhvillimin e evoluimin e saj, gjithnjë si tipar kombëtar identifikues.

Si pjesë e monitorimit të shërbimit të RTSH-së nga ana e AMA-s do të jetë edhe impenjimi për shmangien, në programet e veta, të çdo lloj diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara, për të pasur si pjesë të strukturës programore të transmetuesit publik dhe një edicion lajmesh në ditë, të transmetuar me gjuhën e shenjave, dhe një edicion të titruar.

Në programet kushtuar personave me aftësi të kufizuar, por edhe në programe të tjera, duhet të nxitet e të promovohen përpjekje, sfidat dhe arritjet e personave me aftësi të kufizuar dhe të të moshuarve për t'u integruar në zhvillimet shoqërore, politike, kulturore, e sportive të vendit.

Gjithashtu dhe zgjerimi i gamës së programeve informative, kulturore e shkencore me trajtimin e argumenteve të thelluara do t'i shërbejë edukimit të sensit qytetar, kritik dhe etik, duke iu përgjigjur kështu kërkesave aktuale shoqërore, demokratike e kulturore të shoqërisë, në respekt të diversitetit kulturor si dhe integritetit e kohezionit të kulturës kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë e në trojet e tjera etnike shqiptare, në plotësim të kuotave për emetimin e veprave evropiane dhe të pavarura

8.4 Monitorimi i përmbajtjeve

Monitorimi i tërësisë së programeve të emetuara nga OSHMA-të është bërë në mënyrë sistematike për rastet e subjekteve kombëtare, ndërkohë që për pjesën tjetër rajonale dhe lokale bëhet në mënyrë pjesore, në varësi të planifikimit të shqyrtimeve të tematizuara, të ankesave që mbërrijnë në institucion nga subjekte, institucione ose individë, si dhe bazuar në kapacitetin regjistruar të vetë Studios së Monitorimit dhe Arkivës.

Nga data 1 tetor 2015, me blerjen e një pajisje të re regjistruese, LTO, ka nisur procesi i ndërtimit të arkivës së regjistrimeve programore, një proces që do të vijojë të kryhet sipas standardeve të cilësisë dhe sigurisë, duke skeduar gjithçka sipas rendit kronologjik kohor, për ta bërë më pas të aksesueshme nga specialistët e Studios e të njësive të tjera të AMA-s.

Gjatë vitit 2015 në të gjithë infrastrukturën e Studios janë regjistruar rreth 69 mijë orë programe audiovizive dhe rreth 5 000 orë transmetime audio. Qëllimet kryesore të regjistrimeve janë:

- detyrimet programore;
- reklamat dhe komunikimet tregtare;
- edicionet kryesore informative në subjektet kombëtare;
- shqyrtimi i ankesave për përmbajtje të caktuara.

Në terma statistikorë monitorimi ka qenë:

- monitorimi i programeve të subjekteve audiovizivë, në lidhje me detyrimet programore në total rreth 3500 orë;
- monitorimi i reklamave të transmetuara nga subjektet audiovizivë kombëtarë, në total rreth 14 000 orë programe të monitoruara;

- monitorimi i rreth 900 edicioneve informative të subjekteve audiovizivë kombëtarë dhe 600 edicione të subjekteve audio kombëtare;
- monitorim për subjektet audio, në total rreth 1240 orë;
- monitorime verifikim të respektimit për të drejtat e transmetimit dhe të drejtat e autorit (përfshirë platformat dhe subjektet televizive lokale), rreth 500 orë;
- monitorime për të drejtat e transmetimit në emisione sportive rreth 750 orë transmetimi.

Monitorimi i edicioneve kryesore informative për subjektet kombëtare fokusohet në kohën që ato ju kanë lënë për veprimtaritë e partive politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura, aktorët e ndryshëm politike, veprimtaritë social-ekonomike, etj. Po ashtu pasqyrohen të dhëna të hollësishme mbi prezencën sinkron të personaliteteve politike dhe publike. Pjesë e monitorimit janë përcaktuar edhe të dhëna lidhur me vendin që kanë zënë në edicionet e lajmeve tema të tilla si politika, lajmet ndërkombëtare, ekonomia, veprimtaritë e Parlamentit, të qeverisë, arsimit, arti dhe kultura, kronika e zezë, shëndetësia, kriminaliteti, biznesi, sporti, etj.

Drejtoria e Programeve, në zbatim të ligjit 97/2013, neni 62, pika 12, ka vijuar gjatë vitit 2015 dhe me monitorimin e volumit të reklamave të transmetuara nga subjektet kombëtare, konkretisht TVSH, TOP CHANNEL, TV KLAN. Nxjerrja e të dhënave është bërë çdo muaj dhe duke e finalizuar për gjithë periudhën vjetore.

OSHMA-të	NUMRI I REKLAMAVE	SHUMA NË SEKONDA
TVSH	8.672	394.113
TOP CHANNEL	57.551	1.873.931
TV KLAN	49.695	1.815.201

Shënim: Në nxjerrjen e këtyre të dhënave fasha orare e monitorimit është nga ora 12:00 deri në 24:00; nuk janë përfshirë vendosja e produktit, njoftimet për sponsorizimet dhe njoftimet e OSHMA-ve për programet e veta, si dhe janë përjashtuar ditët kur ka pasur defekt teknik.

8.5 Studio e monitorimit

Një prej detyrave funksionale që kryen Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, sipas ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” është monitorimi në

tërësinë e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive. Regjistrimi, shqyrtimi dhe arkivimi i përmbajtjeve të emetuara është një nga proceset me thelbësore në aktivitetin e AMA-s. Bazuar në këtë depozitë përmbajtjesh realizohen analiza mbi aspekte të ndryshme të programeve, për të evidentuar përputhshmërinë ligjore, nevojën e ndërhyrjes për shkeljet në Kodin e Transmetimit, por dhe për të nxitur produkte të shumëllojshme dhe cilësore për audiencën. Baza e të dhënave të Studios është e dobishme në verifikimin e cenimit të të drejtave të autorit për përmbajtjet e transmetuara, si dhe për rastet e emetimeve pa licencë ose autorizimin e lëshuar nga institucioni.

Studio e Monitorimit aktuale është në gjendje të prapambetur të inventarit teknologjik, për pasojë mjaft nga proceset e punës së skedimit dhe analizimit të materialeve të vizionuara realizohen në mënyrë manuale, duke kërkuar kohë të konsiderueshme. Gjithashtu kapaciteti është i pamjaftueshëm për monitorimin e tërësisë së programeve bazuar në kërkesat ligjore. Konkretisht, monitorohen përmbajtjet programore të vetëm 15 subjekteve, dy pre të cilave janë radiofonike. Në të njëjtën kohë, infrastruktura e amortizuar ekspozon Autoritetin me riskun e humbjes së materialeve të regjistruara si pasoje e pamjaftueshmërisë së kapacitetit mbështetës.

Për të kapërcyer këtë situatë, AMA vlerëson si emergjente gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe në sinkron me nivelin e zhvillimit teknologjike të tregut audioviziv. Nisur nga pamjaftueshmëria për vetëfinancim, si rrjedhojë e kostove të larta të implementimit të sistemeve dhe infrastrukturës së nevojshme, AMA ka hartuar një projekt implementimi dhe ka kërkuar mbështetje nga organizmat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri. Gjithashtu është aplikuar për financim dhe ne projektet IPA që administron Ministria e Integritetit Evropian. Gjithsesi, nuk është bere ende i mundur financimi nga pale të treta për këtë projekt.

8.6 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave

Në zbatim të detyrave funksionale AMA vlerëson kapacitetet e lira të frekuencave të cilat hidhen në garë licencimi për t’iu dhënë në përdorim subjekteve audio dhe audioviziv. Gjatë vitit 2015 nuk janë përcaktuar frekuenca për shërbimet audiovizive pasi ligji 97/2013 ka ndaluar dhënien e licencave për transmetimet televizive analoge tokësore (neni 136) si dhe licencimi i subjekteve për ofrimin e shërbimeve audiovizive numerike ka qenë i lidhur ngushtë me procesin e digjitalizimit të rrjeteve kombëtare private numerike. Gjithashtu, në AMA nuk janë paraqitur kërkesa për caktim frekuence për shërbimet audio (radio FM). Për këtë arsye, përqindjet e mbulimit të territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjektet audio dhe audiovizive nuk kanë pësuar ndryshime nga viti i shkuar.

Në kuadër të planifikimit të spektrit të frekuencave, AMA ka kryer studimet teknike lidhur me kërkesën e RTSH-së për ndryshimet e karakteristikave teknike të rrjeteve numerike, i

cili konsistonte në kryerjen e llogaritjeve kompjuterike për shmangien e interferencave të brendshme dhe të jashtme si dhe për të arritur mbulimin e të gjithë territorit të vendit me shërbime audiovizive.

Gjithashtu janë kryer studime teknike lidhur me optimizmin e rrjeteve private kombëtare numerike duke e shtuar numrin e tyre nga 3 (tre) në 5 (pesë). Mbi bazën e studimeve të kryera u përgatitën karakteristikat teknike të këtyre rrjeteve, të cilat u bënë pjesë e kërkesave teknike të AMA-s për licencimin e operatorëve privatë kombëtare sipas procedurës “Beauty Contest”.



AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV

9.

9.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv

Në përmbushje të funksionit nxitës në rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive, Autoriteti, kishte në fokus shqyrtimin dhe vlerësimin e zhvillimeve në fushën e transmetimeve duke konsideruar cilësinë, shkallën e mbulimit, risitë dhe investimet, në mënyrë që ti paraprinte këtyre zhvillimeve me rolin e tij rregullues dhe nxitës.

Nga vlerësimet e analizave të kryera mbi efektet e ndryshme në këtë treg, në bashkëpunim me aktore të interesuar institucione apo ofrues të shërbimeve mediatike u konkludua se tregu i mediave audiovizive po shkon drejt digjitalizimit, dhe shërbimet e reja që po ofrohen në tregun shqiptar si dhe aplikacionet që mbështetet mbi këto shërbime (IPTV, OTT, Video on Demand etj) kanë rritur ndjeshëm cilësinë e shërbimit, kanë shtuar gamën e programacionit të ofruar publikut ndaj ky trend kërkesash është në rritje.

Me këtë fokus AMA ndërmori implementimin e një plani veprimi që synonte zhvillimin e sistemeve kabllore në Shqipëri, në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve dhe sigurimit të një tregu të qëndrueshëm.

Një ndër hapat kryesore të ndërmarra në zbatim të këtij plani ishte dhe rregullimi i këtij tregu me anë të miratimit në korrik të vitit 2015 të rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”, e cila përcakton autorizimin e subjekteve të interesuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive mbështetur në rrjetet IP (si IPTV, OTT), të cilat ofrojnë aplikacione të shumta për publikun shqiptar (si video on demand, chach up, time shift etj). Subjektet e rinj që aplikojnë për të ofruar transmetime audiovizive mbështetur në sistemet kabllore tashmë nxiten nga AMA për të ofruar shërbimet e tyre vetëm në teknologjinë digjitale në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimit ndaj konsumatorëve shqiptar.


Hap tjetër i ndërmarre në implementimin e këtij plani ishte përcaktimi i zonave të mbulimit të subjekteve që ofrojnë shërbimet e reja IPTV, OTT për të vlerësuar ndikimin e zhvillimeve të reja, nga ku u vlerësua se kërkesat e paraqitura për ofrim të shërbimeve ishin në zonat urbane me përqendrim më të madh të popullsisë si Tirana, Durrësi. Në vijim AMA ndërmori mbledhjen e statistikave nga operatorët që ndodhen në treg mbi treguesit

cilësorë të shërbimit, mbi teknologjinë që përdorin, mbi numrin e ankesave të paraqitura nga konsumatorët në plotësim të informacionit të nevojshëm për të analizuar efektet e nxitës në tregun e transmetimeve audio/audiovizive.

Sa më sipër ka qenë pjesë e strategjisë së komunikimit ku AMA ka theksuar rëndësinë e futjes së shërbimeve të reja bazuar në teknologjitë digjitale në të gjitha takimet e organizuara me subjektet e licencuar/autorizuar gjatë vitit 2015 dhe në të gjitha konferencat apo seminarët e organizuara në lidhje me fushën e mediave audiovizive.

AMA ishte pjesë e Konferencës Botërore e Radiokomunikimeve 2015 (WRC-15) e cila u zhvillua në Gjenevë në datat 2-27 Nëntor 2015. Konferenca ishte e një rëndësie të veçantë pasi administratat e të gjitha vendeve të Rajoneve 1, 2 dhe 3 (vendi ynë bën pjesë në Rajonin 1) ndër të tjera diskutojnë dhe marrin vendime lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përcaktojnë shërbimet për të cilat duhet të përdoren këto frekuenca.

Në përfundim konferenca vendosi që brezi 470- 694 MHz të përdoret vetëm për shërbimet audiovizive dhe ndërkohë në brezin 694-790 MHz (i njohur si brezi i Dividendit Digjital 2) u shtua edhe përdorimi i këtij brezi për shërbimet mobile përveç se atyre audiovizive. Çdo administratë do të vendosë mbi përdorimin e brezit 694-790 MHz (DD2) në varësi të kushteve specifike të çdo vendi.



Përcaktimet e kësaj konference do të kenë ndikim në tregun e medias audiovizive dhe tregun e komunikimeve elektronike të vendit tonë, pasi qeveria shqiptare do të duhet të vendosë përdorimin e këtij brezi në varësi të kërkesave të tregut shqiptar.

Mbi bazën e vendimeve të marra në WRC-15, pritët nga MIAP rishikimi i Planit Kombëtar të Frekuencave. Bazuar në ligjin 97/2013, AMA bashkëpunon me ministrinë për hartimin e këtij plani. Bashkëpunimi konsiston në ngritjen e një grupi të përbashkët me të gjithë institucionet të cilët kanë në administrim frekuenca dhe dhënie kontributeve nga çdo institucion. Me rëndësi në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave do të jetë përcaktimi

i përdorimit të brezit 694-790 MHz (i njohur si dividendi digjital 2) në vendin tonë, nisur nga kushtet aktuale në të cilat ndodhemi.

Lidhur me përdorimin e këtij brezi, MIAP me urdhrin nr. 4770, datë 9.10.2015, ngriti një grup punë për planifikimin e përdorimit të dividendit të dytë numerik (DD2). AMA ka marrë pjesë në takime të grupit të punës dhe ka argumentuar situatën aktuale të tregut audioviziv në Shqipëri.

9.2 Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2015, AMA është angazhuar duke dhënë kontributin e saj si dhe duke bashkëpunuar me institucionet e tjera të përfshira në sistemin e pronësisë intelektuale në vend, për hartimin e draft-Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale për periudhën 2016 -2020, e cila synon rritjen e ndërgjegjësimit, si dhe forcimin e sistemit të regjistrimit, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga Pronësia Intelektuale, si të drejta që ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e ekonomisë.

AMA bashkëpunon me Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), si institucione të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit.

Me miratimin e Projekt-ligjit për të drejtat e autorit do të finalizohet Memorandumi i ri i Bashkëpunimit ndërmjet AMA-s dhe ZSHDA-së, memorandum i cili do të parashikojë mënyrat konkrete të bashkërendimit të veprimeve ndërmjet dy institucioneve, në përmbushje të dispozitave ligjore në fuqi. Megjithatë, gjatë vitit 2015, AMA dhe ZSHDA kanë bashkëpunuar në drejtim të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të transmetimit, kryesisht përmes shkëmbimit të informacioneve.

Nga pikëpamja programore, gjatë vitit 2015, AMA ka ndërtuar komunikimi me disa institucione publike, si Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe Rinisë, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit Publik dhe Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës.

Në kontaktet me këto institucione publike fokusi ka qenë tek shkëmbimi i informacionit për dukuritë dhe trendet në tregun audioviziv të Shqipërisë, duke u fokusuar në problematika konkrete të përmbajtjeve të emetuara, në evidentimin e rasteve kur nga OSHMA-të gjatë mbulimit të ngjarjeve a çështjeve të caktuara janë vënë mangësi etike e profesionale, që kanë cenuar liritë e të drejtat e njeriut.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me këto institucione ka shtuar burimet e informimit në AMA për trajtimin dhe shqyrtimin e problemeve në programet audio dhe audiovizive, duke sinkronizuar mbështetjen për cilësinë e produkteve për audiencën, respektimin e të drejtave për transmetimin e produkteve të të tretëve etj.

Gjatë vitit 2015 në zbatim të frymës së partneritetit me OSHMA-të janë zhvilluar dhe takime me grupet e interesit, me transmetuesit radiofonikë, televizivë, platformat digjitale etj. AMA ka dëgjuar me kujdes problematikën e trajtuar nga operatorët, duke përçuar tek menaxherët dhe stafet e tyre aspekte të evidentuara që kërkojnë respektimin e ligjit dhe të akteve nënligjore, si instrumente të konkurrencës së ndershme dhe kundër prijeve monopoliste në tregun audioviziv, në shërbim cilësor dhe të shumëllojshëm për publikun.

Në 2015 për herë të parë u aplikua dhe një instrument nxitës për redaksitë e OSHMA-ve, duke shfrytëzuar partneritetin që AMA ka me disa prej institucioneve dhe organizmave që punojnë në fushën e medias dhe të komunikimit. Në kuadër të riorganizimit u përcaktua si objektivi bashkëpunimi me subjektet partnere për organizimin e formateve të ndryshme kualifikuese profesionale për gazetarët, redaktorët e reporterët e subjekteve audio dhe audiovizive, në formën e workshop-eve, seminareve, tryezave të rrumbullakëta, forumeve të debatit etj., ku në qendër të ishin disa prej problematikave thelbësore të programacionit në radio e televizione, në sinkron dhe me interesat e audiencës në nivel komunar, lokal, rajonal e kombëtar, në transmetimet publike a private.

Konkretizimin e objektivit AMA e filloi me një projekt bashkëpunues me Institutin Shqiptar të Medias, ISHM në Tiranë. Në datat 16 dhe 17 dhjetor 2015 u realizua moduli trajnues: “Përmirësimi i raportimit të çështjeve të fëmijëve në median audiovizive”, ku u përfshinë në grup prej 20 gazetarësh dhe redaktorësh që punojnë në mediat audiovizive publike dhe private, kombëtare dhe lokale. ISHM është e vetmja strukturë profesionale e standardizuar edhe nga institucione ndërkombëtare që punon në fushën e trajnimeve dhe kualifikimeve në media e komunikim.

Temë qendrore për projektin ishte mbrojtja e të miturve në ekran, si një aspekt jo vetëm sensitiv për audiencën, por dhe mjaft problematik në performancën profesionale dhe etike të OSHMA-ve.

Ekspertët e angazhuar në këtë projekt, në seanca të veçanta, diskutuan me pjesëmarrësit tema që lidhen me kuadrin legjislativ dhe rregullator në transmetimet audiovizive; dispozitat kushtetuese dhe Konventa për të drejtat e fëmijëve; formatet e raportimit, burimet dhe teknikat e intervistimit, specifikat e pasqyrimit të problematikës së fëmijëve në mediat audiovizive-puna në redaksi dhe njohuritë që gazetari social duhet të zotërojë për një pasqyrim sa më të plotë dhe frytdhënës; njohja e gazetarëve me Kodin e Transmetimit të AMA-s, roli dhe ndikimi i Transmetuesit Publik; emisionet për fëmijët dhe të rinjtë si mënyrë të shprehuri etj. Pjesë e diskutimit në modul ishin dhe rastet studimore të marra nga media audiovizive shqiptare, lidhur me etikën dhe fëmijët.

Projekti “Përmirësimi i raportimit të çështjeve të fëmijëve në median audiovizive” është projektuar që të vijojë dhe në stacione të tjera jashtë Tiranës gjatë vitit 2016, ku përfitues do të jenë gazetarë, redaktorë e reporterë nga OSHMA-të në qarqe të ndryshme të vendit, si në Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Shkodër e Vlorë. Ndërkohë në qendër të eventeve kualifikuese dhe tryezave të debatit me gazetarët do të ketë dhe çështje të tjera, evidente si problematike në transmetimet audiovizive, si përdorimi i gjuhës shqipe, barazia gjinore, grupet e marginalizuara, komunikimet tregtare dhe reklamat etj.)

9.3 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore

Viti 2015 ka pasur si risi një qasje të veçantë me institucionet dhe organizatat që punojnë në fushën e medias dhe të komunikimit. Partneriteti është orientuar dhe organizimin e veprimtarive me karakter shkencor dhe studimor, në përputhje me funksionet e objektivat e AMA-s të parashikuara nga ligji organik 97/2013. Duke qenë se digjitalizimi i transmetimeve televizive tokësore ka qenë një prej sfidave kryesore të tregut audioviz shqiptar dhe ku AMA ka një rol shumë të rëndësishëm në këtë proces, bashkë dhe me aktorë të tjerë institucionalë në vend;

Duke qenë se Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës është një strukturë publike lider në Shqipëri për punën kërkimore shkencore në fushën e medias dhe të komunikimit dhe si organizatore e eventeve të rëndësishme studimore në rang kombëtar dhe ndërkombëtar- në mars të vitit 2015 u arrit një akord bashkëpunimi mes dy institucioneve me qëllimin e organizimit të një konference ndërkombëtare në Tiranë në muajin nëntor.

Ky produkt nuk u planifikua thjesht si një pikëtakimi ku referentë dhe diskutant të vendas dhe të huaj do të prezantonin këndvështrimet e tyre për aktualitetin dhe perspektivën e digjitalizimit, por u konsiderua si një hapësirë shumëplanëshe hulumtimi në treg dhe në literaturën bashkëkohore. Ndaj dhe konferencës “Digjitalizimi i transmetimeve televizive tokësore: sfida paradokse, shpresa” i parapriu një operacion kërkimor në mbledhjen e të dhënave nga pedagogët dhe studentët e Departamentit, duke e qëmtuar procesin nga këndvështrimi i vetë operatorëve audiovizivë, nga menaxherët e tyre, platformat digjitale, redaksitë që kujdesen për përmbajtjet, roli dhe ndikimi i autoritetit rregullator etj.

Përmes kërkimit shkencor 4 mujor u bë e mundur që të ngrihej një qendër bibliotekare dhe dokumentare pranë Departamentit, me libra e studime të huaja, në anglisht, për procesin e digjitalizimit, e cila ishte në dispozicion të grupit të studiuesve dhe referentëve të Konferencës. Në dispozicion të këtij grupi u vunë dhe të gjitha anketimet dhe intervistat e bëra me operatorë televizivë, si edhe të dhëna të bollshme sasiore mbi sjelljen e audiencave, të gazetarëve etj.

Konferenca shkencore ndërkombëtare e 25 nëntorit 2015 u mbështet në disa akse kryesore të debatit mes ekspertëve të fushës vendas dhe të huaj, si sfidat teknike dhe teknologjike të digjitalizimit; efektet ekonomike e financiare; cilësia e informacionit në kushtet e emetimit digjital; oferta e internetit në transmetimet audiovizive; roli, ndikimi dhe përshtatja e autoritetit rregullator në kushtet e peizazhit digjital.

Baza dokumentare e saj, kërkimet në terren, eksplorimi në literaturën vendase dhe të huaj, referimet dhe diskutimet në panele – në versionin print nga një botim përmbledhës dhe në atë elektronik -nga publikimi në YouTube- janë një depozitë e vyer që do të mund të përdoret nga studentët dhe pedagogët e gazetarisë dhe të komunikimit në Tiranë dhe rrethe, nga grupet e interesit, nga cilido që kërkon informacion dhe ekspertizë në këtë fushë).

Gjithashtu në Maj 2015, u zhvillua, në Bernë të Zvicrës, takimi i 41-të i Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatorë (EPRA), ku ishte pjesëmarrës dhe delegacioni nga AMA.

Çështjet kryesore që u diskutuan lidheshin me sigurimin e një ekosistemi të qëndrueshëm në përmbajtjen e mediave Evropiane, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë rreth aspekteve të konsumit dhe shpërndarjes, si dhe mbi alternativat aktuale që kanë për qëllim monitorimin e pluralizmit të mediave. Gjatë takimit u krijuan grupe pune me autoritetet rregullatorë të vendeve të ndryshme pjesëmarrëse, në mënyrë që të shkëmbenin eksperiencat e tyre duke u fokusuar në:

- përcaktimin e fushëveprimit të shërbimit publik dhe çështjeve financiare gjatë epokës digjitale;
- tendencat dhe sfidat në komunikimet komerciale audiovizive;
- rregullatorët dhe mënyrat kërkimore me fokusin në çështjet që lidhen me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të siguruar një “dëshmi-bazë” në mënyrë që këta rregullatorë të përmbushin qëllimet e tyre.

Në kuadër të prioritetit në fushën e programacionit, AMA mori pjesë në grupin e dytë të punës duke marrë eksperiencat e duhura në fushën e komunikimeve tregtare audiovizive.





DIGJITALIZIMI

10.

10.1 Angazhimi i Autoritetit në përmbushjen e të gjitha hallkave të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike

Gjatë vitit 2015 AMA ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme në kuadër të angazhimeve të saj për përmbushjen e të gjitha hallkave të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike. Në fokus të këtyre aktiviteteve ka qenë administrimi i hallkave të ndryshme të procesit të digjitalizimit:

- Koordinimi me RTSH për përshpejtimin e procesit të implementimit të rrjeteve numerike, vlerësimin e pajtueshmërisë me kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare të transmetimeve audiovizive të miratuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) si dhe nxitja për administrimin dhe përmbushjen e detyrave të përbashkëta, AMA – RTSH, në kuadër të zbatimit të Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike.
- Koordinimi me operatorët privatë historikë kombëtarë dhe me eksperience në transmetimet numerike për rishikimin e kuadrit nënligjor që rregullon procesin e licencimit, i kontestuar në gjykatë gjatë vitit 2013 si dhe përcaktimi i karakteristikave teknike për transmetimet numerike sipas standardeve ndërkombëtare të miratuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU).
- Koordinim me operatorët analogë vendorë për administrimin e procesit të mbartjes së transmetimeve analoge ekzistuese në rrjetet e operatorit publik dhe të operatorëve private kombëtare.

10.2 Ndërtimi i rrjeteve digjitale të RTSH

Roli kryesor i AMA-s, në procesin e digjitalizimit të transmetimit të RTSH është caktimi i frekuencave dhe mbikëqyrja e zbatimit të marrëveshjes së Genevë06, ratifikuar nga Parlamenti shqiptar në vitin 2007. AMA, që në shkurt të vitit 2013, ka miratuar hapësirat maksimale të përcaktuara në ligj duke i akorduar transmetuesit publik 2 rrjete kombëtare, duke konsideruar me rendësi të veçantë përmbushjen e misionin publik të RTSH si dhe krijimin e hapësirave maksimale për operatorët vendorë analogë ekzistues që do të

zgjedhin të mbështeten në rrjetet e RTSH për kalimin në transmetimet numerike. Me këtë vendim AMA i hapi rrugën procesit të ndërtimit të rrjeteve të RTSH për digjitalizimin e transmetimeve transmetuesit publik.

Pas një periudhe dy vjeçare gjatë së cilës nuk u pati zhvillime në procesin e ndërtimit të rrjeteve të RTSH-së, projekti i RTSH për ndërtimin e tyre, dërguar tek AMA në shtator të vitit 2015, konsistonte në ndryshime të konsiderueshme të vendimeve të AMA-s. Si rrjedhojë, AMA kreu të gjitha aktivitetet për vlerësimin e pajtueshmërisë së këtyre ndryshimeve me marrëveshjen e Ge06 dhe standardeve të ITU-së. Pas kalkulimeve të karakteristikave teknike të projektit të propozuar nga RTSH u konstatua se rreth 80 për qind e transmetuesve tejkalonin ndjeshëm kufizimet e fuqisë së transmetimit të përcaktuara nga AMA dhe të miratuara nga ITU. Kalkulimet u kryen me sisteme informatike të certifikuar dhe të rekomanduara nga ITU. Në fillim të muajit Tetor, AMA informoi RTSH në lidhje me këto pa përputhshmëri dhe lëshoi rekomandimet përkatëse, të cilat u reflektuan në projektin e ndërtimit të rrjeteve. Puna për implementimin e rrjeteve numerike të RTSH-së filloi në muajin Tetor 2015.

Gjatë vitit 2015, janë shkëmbyer korrespondenca shkresore dhe janë organizuar një sërë takimesh me përfaqësues të RTSH-së dhe MIAP në lidhje me diskutimin e çështjeve teknike të tilla si përcaktimi i fazave të implementimit të rrjeteve numerike dhe përcaktimi i vendndodhjeve të pikave të lidhjes së rrjetit të RTSH-së me subjektet private lokale/rajonale dhe mënyrat teknike të lidhjes.

Përcaktimi i fazave të implementimit të rrjetit shërben që AMA të koordinojë procesin me operatorët lokalë/rajonale të cilët duan të mbështeten në rrjetin e RTSH-së si dhe të vijoje me procesin e informimit të publikut. Koordinimi konsiston në përcaktimin e detajeve teknike të sjelljes së sinjaleve të operatorëve lokalë/rajonale në pikat e përcaktuara nga RTSH në çdo allotment, në mundësinë e përcaktimit të frekuencave për periudhën e transmetimit simulcast të subjekteve të licencuar nga AMA, në procesin e migrimit të frekuencave si dhe në përcaktimin e afatit të lirimit të brezit Digjital Dividend 1 (i cili është përcaktuar për përdorim për shërbimet mobile pas përfundimit të procesit e digjitalizimit).

10.3 Licencimi i transmetuesve privatë kombëtarë dhe ato me eksperiencë në transmetimet numerike

Për të përshpejtuar procesin e licencimit, një proces i cili është pezulluar për shkak të procesit gjyqësor, AMA, në muajin janar 2015 ka filluar fazën e konsultimit me subjektet kombëtare historike dhe ata me përvojë në transmetimet numerike për marrjen e mendimin e tyre si palët e interesuara në këtë proces, për miratimin e rregullores “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së Beauty

Contest”. Pas procedurave administrative, AMA, me vendimin nr. 28, datë 2015/04/16 dhe vendimi nr. 29, datë 16.4.2015, AMA miratoi rregulloren “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre përmes procedurës së Beauty Contest”, dhe hapi procedurën për lëshimin e pesë licencave private kombëtare për transmetimin digjital audiovizive, sipas procedurës së Beauty Contest.

Në fillim të vitit 2015, AMA rishikoi mundësinë e optimizimit të rrjeteve të caktuar për operatorët privatë duke e rritur numrin nga 3 (tre) rrjete kombëtare në 5 (pesë) të tilla. Rishikimi i optimizimit të rrjeteve u krye bazuar në kërkesat e ligjit 97/2013. Neni 139 i ligjit ngarkon AMA-n për përcaktimin e numrit të licencave të transmetimeve numerike private kombëtare si dhe përcaktimin e operatorëve privatë historikë kombëtarë, si dhe operatorëve ekzistues, me eksperiencë në transmetimet numerike, që ftohen të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes, sipas beauty contest-it për rrjetet numerike kombëtare.

Bazuar në zhvillimet e tregut të transmetimeve audiovizive, në të cilin operojnë aktualisht 2 operatorë kombëtarë të licencuar nga AMA (Top Channel dhe Klan) dhe ofrojnë shërbime audiovizive bazuar në teknologjinë digjitale tre subjekte (Digitalb, Supersport dhe Tring TV), të cilët janë të pranishëm në pothuaj gjithë territorin e vendit dhe programet e tyre ndiqen me interes nga pjesë e konsiderueshme e popullsisë, AMA vendosi optimizimin e rrjeteve kombëtare private numerike. Në arsyetimin e saj për optimizimin e rrjeteve kombëtare AMA është bazuar edhe në rekomandimet e ITU-së dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme teknike.

Bazuar në marrëveshjen GE06 e cila ka përcaktuar kanalet e frekuencave për ndërtimin e rrjeteve numerike lokale/rajonale dhe kombëtare në Republikën e Shqipërisë, rezulton se janë përcaktuar 7 rrjete kombëtare në brezin UHF (2 prej tyre janë rrjetet e RTSH-së dhe 5 janë rrjete kombëtare private), 1 rrjet kombëtar në brezin VHF dhe 9 kanale që do të planifikohen nga AMA për ndërtimin e rrjeteve lokale/rajonale.

Në tabelën e mëposhtme, vihet re se dy rrjete kombëtare (rrjeti 6 dhe 7) kanë mangësi të kanaleve të frekuencave në dy allotmente (Lezhe, Vlore), pasi kanalet 64, 66 dhe 68 të përcaktuara për këto allotmente bëjnë pjesë në brezin 790-862 MHz (dividendi digjital 1), brez i përcaktuar për përdorime për shërbimet mobile.

Për plotësimin e këtyre dy rrjeteve me frekuencat për allotmentet Lezhë dhe Vlorë, AMA prej më se një viti, ka nisur një proces negociatash me Departamentin e Komunikacioneve të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Italisë. Nga kjo veprimtari është arritur të konkludohet një marrëveshje paraprake për akordimin nga ana e tyre të 2 kanaleve për allotmentet e Lezhës dhe Vlorës për rrjetin 6 e 7.

Allotmentet											
Rrjeti 1	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastër	Vlorë
Rrjeti 2	22	26	24	23	21	23	22	24	21	26	23
Rrjeti 3	28	32	25	29	34	33	27	25	27	29	39
Rrjeti 4	34	36	30	33	39	40	28	30	28	35	43
Rrjeti 4	41	40	38	43	41	42	29	32	43	37	46
Rrjeti 5	45	42	54	46	53	46	31	36	45	38	57
Rrjeti 6	51	50	55	66	57	48	35	47	51	44	64
Rrjeti 7	59	52	60	68	59	49	45	52	55	48	68
8 (VHF)	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8	6
		56	63		61	56	51	54	57	50	
		65	69			58		61	59	53	
						62		65	64	56	
						68		66		58	
										60	
										63	
										67	
										69	

1 Frekuencat e shënuara me ngjyre të kuqe në tabelën 1 i përkasin brezit të Digjital Dividend 1 (kanalet 61 - 69) i akorduar për përdorim në telefoninë Mobile. Si rrjedhojë, këto frekuenca nuk mund të përdoren për transmetime audiovizive.

Gjatë fazës së optimizmit, AMA kreu studimet teknike lidhur me përcaktimin e karakteristikave teknike të 5 rrjeteve private kombëtare numerike dhe hapi garën për licencimin e tyre. Në përcaktimin e karakteristikave teknike u mbajt parasysh shmangia e interferencave të brendshme dhe atyre ndërkombëtare si dhe njëkohësisht plotësimi i kriterëve të mbulimit të territorit të Republikës së Shqipërisë. AMA ka hartuar kuadrin nënligjor për licencimin e rrjeteve numerike pas periudhës tranzitore, sipas nenin 70 të ligjit 97/2013 dhe brenda muajit Shkurt 2016 do të nise fazën e konsultimit publik.

Karakteristikat teknike të dekoderëve. AMA me vendimin Nr. 03 datë 04.02.2015, ndryshuar me vendimin Nr. 38, datë 11.05.2015 ka përcaktuar specifikimet teknike të marrësve numerik tokësor me qëllim mbrojtjen e përdoruesve fundorë. Në këto specifika u përcaktua në mënyrë të qartë tipologjia dhe specifikimet e pajisjeve marrëse tokësore në mënyrë që në treg të shpërndahen vetëm pajisje që janë në përputhje me karakteristikat teknike të rrjeteve numerike të transmetimit audioviziv.

Procesi i koordinimit dhe notifikimit të frekuencave. Koordinimi për shfrytëzimin dhe optimizmin e frekuencave sipas planit GE06 me vendet fqinje kryhet bazuar në radio rregulloret e ITU-së si dhe marrëveshjen GE06. Njohja përfundimtare e karakteristikave teknike të transmetimit (si frekuenca, pika transmetuese, fuqia transmetuese E.R.P) nga vendet fqinje dhe ITU, do të realizohet pasi të fillojnë transmetimet digjitale në Republikën e Shqipërisë. Kjo për arsye se mund të shkaktohen interferenca në vendet fqinje dhe mund të lind nevoja e rishikimit të parametrave teknike të transmetimit. Në rastet kur nuk do të ketë interferencë do të kërkohet njohja përfundimtare nga vendi fqinj dhe ITU e karakteristikave teknike të transmetimit për secilin kanal (frekuencë).

10.4 Koordinimi me RTSH-në për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përbashkëta, lidhur me procesin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike

- Përcaktimi i kriterëve dhe numrit të programeve publike që do të transmetohen (falas), si dhe ato me akses të kushtëzuar.

AMA, prej dy vitesh ka ndërhyrë intensivisht, si me forme shkresore ashtu dhe në mbledhjet e organizuara me staf drejtues të RTSH-se, për përfundimin e këtij procesi. Vërejmë se TVSH ende nuk ka dërguar materiale të aprovuara nga Bordi Drejtues, siç përcaktohet në dispozitat ligjore.

- Parimet dhe kriteret e kontratave të lidhura ndërmjet TVSH dhe operatorët ekzistues private lokale.

Si faze qe paraprin miratimin, AMA ka bërë propozimet dhe komentet e ndryshme të cilat duhet të reflektohen në draft kontratën që do të rregullojë procesin e mbështetjes së operatorëve privatë lokalë në rrjetet e RTSH.

Nuk është propozuar ende një draft kontrate e miratuar paraprakisht në Bordin Drejtues të RTSH.

- Kriteret për përcaktimin e pagesave të operatorëve ekzistues analogë privatë për të mbështetur rrjetin numerik të TVSH dhe pagesa për çdo kategori.

Strategjia përcakton metodologjinë për llogaritjen e pagesave të operatorëve ekzistues analogë për mbështetje në rrjetin e TVSH. Për këtë çështje, AMA ka ofruar ndihmë dhe sugjerime saj, në takime të drejtpërdrejta si dhe në mbledhjet e Sekretariatit Teknik. Gjithsesi, është në kompetence të RTSH për të përcaktuar tarifat për shërbimet që do tu ofrojnë operatorëve ekzistues analogë, të cilat do të miratohen më pas nga AMA.

Gjatë vitit 2015, nga RTSH janë propozuar disa tarifa por që nuk kanë qenë të aprovuara nga Bordi Drejtues i RTSH-se. Gjithsesi, këto tarifa rezultojnë të larta, bazuar dhe në studime qe AMA ka kryer mbi nivelin aktual të pagesave për infrastrukturën transmetuese me të cilat operojnë në treg operatorët lokale vendore. Kjo sjell pengesa në mbarëvajtjen e procesit të mbylljes së transmetimeve analoge pasi përball operatorët lokale vendore me peshë financiare të lartë dhe të paparashikuar, në një moment kur mbyllja e transmetimeve analoge dhe kalimi në transmetimet numerike është detyrim ligjor.

Në qershor të vitit 2015 AMA organizoi një takim konsultativ me operatorët televizivë lokalë dhe rajonalë me fokus kryesor problematikat e mbështetjes së operatorëve në rrjetin e TVSH-së, si dhe përlllogaritjen e tarifave përkatëse gjatë procesit të digjitalizimit, ku u theksua rëndësia për të pasur një proces transparent dhe të bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në strategjinë kombëtare të kalimit të transmetimeve nga analogu në numerik, duke sjellë një produkt më të mirë për publikun dhe me kosto sa më të ulët.

Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike ka parashikuar që tarifa e mbështetjes së operatorëve analogë vendorë në rrjetin numerik të RTSh, të përcaktohet duke u bazuar në kostot e ndërtimit të rrjetit. Sipas llogaritjes së zërave përkatës, tarifa për mbështetjen në rrjetin e RTSh-së rezultoi në 2'880 Euro/Muaj për allotment.

Mbas një sërë takimesh dypalëshe midis AMA-s dhe RTSh-së u dakordësua për rishikimin e metodologjisë së përlllogaritjes së tarifës së mbështetjes.

U përcaktua që metodologjia e përlllogaritjes së tarifës të konsideronte vetëm zërat financiarë që lidhen me mirëmbajtjen e rrjetin numerik dhe jo të ndërtimit të tij. Ky propozim gjeti dhe dakordësinë e Komitetit Ndërinstitucional për zbatimin e Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike.

Bazuar në sa më lart, në muajin Janar, 2016, Bordi i RTSH miratoi tarifën e mbështetjes së operatorëve analogë në rrjetin numerik qe rezulton në 1073 Euro/Muaj për allotment.

Gjatë muajit Shkurt 2016, AMA organizoi serish një takim konsultativ me operatorët televizivë lokalë dhe rajonalë, të cilët shprehën serish vështirësitë financiare të tyre për të përballuar tarifën e mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-se. AMA është duke vlerësuar pajtueshmërinë me kuadrin ligjor dhe nënligjor së metodologjisë dhe informacionit financiar të vënë në dispozicion nga RTSH dhe brenda muajit shkurt do të shprehet për miratimin e tarifës.

Kontrata e shërbimit publik (AMA - RTSH)

Kontrata e shërbimit publik do të rregullojë aspekte shume të rëndësishme të veprimtarisë së RTSH, siç përcaktohet në ligjin 97/2013. AMA ka bërë propozimet dhe komentet e ndryshme të reflektohet mbi projekt-kontratës së propozuar nga RTSH. Në pritje të përfundimit të procesit publik dhe miratimit të draft kontratës nga Bordi Drejtues i RTSH, AMA ka hartuar një politikë në lidhje me vlerësimin e draftit final të kësaj kontrate.

Në takimet e përbashkëta me RTSH gjatë vitit 2015, një nga temat e diskutuara ka qenë dhe buqeta programore që do të ofrohet nga transmetuesi publik në platformën e vet. Për AMA-n procesi i kalimit nga analogu në numerik nuk mund të ketë vetëm fokus teknik dhe teknologjik, si dhe argument të kostove për bartjen e stacioneve të tjera. Por të marrë vëmendjen e duhur dhe konceptimi e ndërtimi i një fluksi kanalesh, të cilat duhet t'i përgjigjen nevojave të qytetarëve, në mënyrë që ata të kenë akses dhe mundësi që të përzgjedhin nga oferta e platformës së transmetuesit publik, duke përmbushur pa pagesë nevojat për informacion, edukim dhe argëtim. Pra, për të arritur në dy parametrat bazikë të fluksit të përmbajtjeve: cilësinë dhe shumëllojshmërinë, në shërbim të të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare.

10.5 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital

Lirimi i brezit 790-862 Mhz, i njohur si Digjital Divident 1 (kanalet nga 61-69), duhet të ishte realizuar me përfundimin e periudhës së transmetimeve analoge që i përkon datës 17 Qershor 2015 sipas përcaktimeve ligjore. Mosrealizimi i këtij afati ka sjellë anomali të theksuara në raport me transmetimet e komunikimeve elektronike të vendeve fqinje, në veçanti Italisë, e cila ka bërë ankesa të vazhdueshme për interferencat që i shkaktohen nga subjektet tanë audiovizive në këto breza. Ndërtimi i rrjeteve numerike të RTSH-së dhe licencimi i operatorëve numerik kombëtar privat do të çonte në lirimin e kanaleve të zëna nga operatorët lokal/rajonal.

Ndërkohë në kuadër të planifikimit të spektrit të frekuencave janë përcaktuar subjektet të cilët kane aktualisht në përdorim kanalet e frekuencave që bëjnë pjesë në këtë brez. AMA do të koordinojë me operatorët që kanë në përdorim këtë brez si dhe me RTSH-në, duke ndjekur hap pas hapi për çdo allotment procesin e migrimit të frekuencave në mënyrë që të përcaktohen edhe afatet për lirimin e plotë të brezit Digjital Dividend 1.

Procesi i ndërtimit të rrjeteve të RTSH dhe i koordinimit të detyrave të përbashkëta AMA – RTSH në kuadër të procesit të digjitalizimit ka hasur pengesa edhe gjatë vitit të fundit. Disa prej çështjeve që duhet të ishin trajtuar më me prioritet dhe që ndikojnë direkt në mbarëvajtjen e procesit janë:

- Përgatitja e projektit të ndërtimit të rrjeteve nga RTSH, dhe më tej zgjidhja e mospërputhjeve të këtij projekti me vendimet e AMA-s dhe me standardet ndërkombëtare të transmetimeve audiovizive të përcaktuara nga ITU.
- Përcaktimi i tarifës së mbështetjes së operatorëve televizive lokalë, çka ka penguar mbarëvajtjen e procesit. Kjo pasi përfundimi i procesit të digjitalizimit dhe i lirimit të brezit të frekuencave të DD1 nuk përkon me përfundimin e rrjeteve numerike të RTSH por me mbylljen e transmetimeve televizive analoge. Faza e mbartjes së transmetimeve analoge të operatorëve lokalë në rrjetet numerike të RTSH është hallke mjaft delikate e procesit të digjitalizimit pasi, përveç se duhet të garantojë mos cenimin e të drejtës së publikut për informim, përmban mjaft elemente teknike dhe financiare, zgjidhja e të cilave kërkon koordinim dhe përqasje proaktive nga të gjitha palët e përfshira në proces. Vonesat në përcaktimin e tarifës kane penguar seriozisht edhe procesin koordinues që AMA ka planifikuar të kryejë me operatorët analogë lokalë.
- Vonesa nga ana e RTSH – së janë konstatuar dhe në hartimin e kontratës së shërbimit publik e cila përmban edhe elemente rregullatorë që rregullojnë aspekte të rëndësishme të procesit të digjitalizimit, si numrin e programeve që do të transmetohen në një nga rrjetet e RTSH-së, kritereve cilësorë të transmetimit, etj.
- Edhe pse ndërtimi i rrjeteve të RTSH-se është në faze implementimi, AMA nuk është vene ende në dijeni mbi grafikun e punimeve ku përcaktohen dhe allotmentet e para që do të jënë gati për transmetimet numerike si dhe afatet e përfundimit të tyre. Në këtë mënyrë vështirësohet ndjeshëm mbarëvajtja dhe efikasiteti i fushatës së informimit të publikut e cila duhet të operojë në baze të një grafiku që ndërlidhet direkt me ecurinë dhe përfundimin e rrjetit në çdo allotment. Në këto rrethana rrezikohet që publiku të mos informohet në kohë mbi veçoritë e procesit si dhe masat që duhen marrë për të pasur akses në transmetimet e reja numerike. Në momentin që flasim ende nuk jemi bërë me dije mbi allotmentet e para në të cilët parashikohet fillimi i transmetimeve numerike dhe afatet përkatëse, çka do të diktonte dhe fillimin e fushatës së informimit të publikut.

Lirimi i brezit të DD1 nga operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike lidhet direkt me migrimin e transmetimeve të tyre në frekuencat e përcaktuara nga AMA në dokumentacionin e licencimit. Siç është shtjelluar më lart, procesi i licencimit të operatorëve privatë kombëtarë dhe me eksperiencë në transmetimet numerike nuk ka përfunduar ende.

10.6 Administrimi i Digjital Dividend 2

Me iniciative të Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, dhe me pjesëmarrjen e AMA-s, AKEP e aktoreve të tregut të transmetimeve audiovizive dhe të telekomunikacionit, gjatë vitit 2015 janë kryer disa takime ku është trajtuar administrimi i brezit të dytë të Dividendit Digjital. Argumentet dhe sugjerimet e AMA-s për administrimin e këtij brezi kanë qenë kryesisht si vijon:

- Frekuencat për licencimin e rrjeteve të operatorëve audiovizivë kombëtarë dhe me eksperiencë në transmetimet numerike janë përcaktuar nga AMA në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi:
 - Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;
 - VKM Nr. 292, date 2.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike” (Strategjia);
 - VKM nr. 466, date 27.02.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (Plani Kombëtar i Frekuencave);
 - Aktet finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacionit (RRC 06), ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9851, 26.12.2007;
 - Rregulloren për licencimin e rrjeteve numerike private kombëtare nëpërmjet procedurës së Beauty Contest.
- Frekuencat e Brezit të Digjital Dividend 2 cenojnë (prekin) të gjitha rrjetet kombëtare që do të licencohen dhe ndërtohen nga operatorët privatë kombëtarë dhe me eksperiencë në transmetimet numerike si dhe përkrijnë gjithashtu me të gjitha frekuencat e caktuara për ndërtimin e rrjeteve nga operatorët rajonalë e lokalë.
- Referuar situatës aktuale të tregut të mediave audiovizive në vendin tone, i cili përbehet nga 70 operatorë lokalë, dy operatorë kombëtarë dhe 3 platforma numerike, krahasuar me numrin e popullsisë së vendit tonë, vihet re se numri i operatorëve është më i madh se në vendet e tjera të rajonit. Ky është një tregues se kërkesa e konsumatorit shqiptar për shërbime audiovizive është e lartë. Me gjithë zhvillimet e viteve të fundit të transmetimeve audiovizive në rrjetet kabllore dhe mbi internet, infrastruktura e rrjeteve të operatorëve aktualë audiovizive dhe platforma në të cilën pjesa më e konsiderueshme e shikuesve kanë akses në

transmetimet audiovizive është ajo e transmetimeve tokësore.

- Gjithashtu, ndryshimet e vullshme teknologjike në fushën e mediave audiovizive, janë pasuar me investime në vlera disa milionë euro, të kryera nga operatorët audiovizivë, Investime të cilat institucionet shtetërore kane për detyrë t'i mbrojnë në kuadër të përfitimeve që sjellin për publikun dhe shtetin shqiptar.
- Në kuadër të këtyre investimeve janë përcaktuar dhe afatet e vlefshmërisë së licencave për rrjetet numerike tokësore, 15 vjet për licencat kombëtare dhe 8 vjet për ato rajonale e lokale. Për veç se këto afate janë përcaktuar duke u mbështetur në përvojat e pjesës më të madhe të vendeve evropiane, ato marrin në konsideratë faktorët ekonomiko-financiar që lidhen me ndërtimin e rrjeteve numerike dhe garantojnë kohën e nevojshme për kthimin e këtyre investimeve.
- Zgjidhjet e parashtruara për lirimin në kohë sa më të shpejtë të brezit të DD1 dhe që mbështeten nga të gjitha palët e përfshira në proces, janë në kundërshtim me aplikimin e lirit të brezit DD2 në terma afatshkurtra madje dhe afatmesme.
- Lidhur me diskutimet mbi përdorimin e brezit të DD2 vlerësojmë se nevojiten studime dhe analiza më të thelluara nga të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces, lidhur me kërkesën e tregut të mediave audiovizive dhe tregut të komunikimeve elektronike (operatorëve mobile). Gjithashtu, nevojitet analize e thelluar mbi trendin e zhvillimeve teknologjike në fushën e mediave audiovizive dhe komunikimeve elektronike, në mënyrë që të kryhet një vlerësim i drejtë i kërkesës së tregut për përdorimin e këtij brezi.
- Këto studime dhe analiza duhet të kenë në fokus garantimin dhe mbrojtjen e shërbimeve audiovizive në kuadër të mbrojtjes së vlerave kulturore dhe kombëtare transmetuar për publikun ndër vite nga mediat audiovizive si dhe garantimin e mbrojtjen e investimeve të kryera nga operatorët e mediave audiovizive në kuadër të procesit të digjitalizimit të rrjeteve dhe shërbimeve të tyre.

10.7 Fushata e informimit të publikut dhe koordinimi me operatorët audiovizive

Bazuar në Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Strategjinë e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, si dhe Planit të Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie, AMA u angazhua në përgatitjet për zhvillimin e fushatës së informimit të publikut dhe aktorëve të tregut audioviziv mbi mënyrat e kalimit në transmetime numerike.

Në përmbushjen e këtij objekti AMA, me qëllim njohjen e operatorëve audiovizivë me kuadrin rregullator si dhe informimin e publikut për procesin e kalimit në transmetimet numerike, ka parashikuar një sërë mjetesh për t'i komunikuar publikut dhe operatorëve audiovizivë për fillimin e procesit, si dhe vazhdimësinë dhe mënyrën sesi do të shpërndahej në territorin e vendit si edhe për problemet që do të mund të hasen në vazhdimësi të procesit.

AMA ka parashikuar këto mënyra informimi për procesin e digjitalizimit:

- Spote televizive
- Broshura
- Fletëpalosje
- Strukturë Call Center
- Takime me OSHMA-të – 1 kombëtar dhe 3 rajonalë
- Emisionet televizivë, botime, shkrime etj.

Spotet audio dhe audiovizive

Gjatë vitit 2015, AMA realizoi tre spote audiovizive informuese për publikun, transmetimi i të cilave do të filloi përpara ndalimit të transmetimeve analoge. Këto spote përmbajnë informacione vizive mbi impaktin që sjell procesi i digjitalizimit, teknologjinë që do përdoret, karakteristikat e dekodeve dhe mënyrat e instalimit të tyre si dhe skemën e shpërndarjes së dekodeve tek familjet në nevojë.



AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL

11.

11.1 Strategjia e komunikimit në kuadër të transparencës

Strategjia e komunikimit është vlerësuar nga Autoriteti si një mënyrë konkrete përmes së cilës ai ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, duke u angazhuar në përditësimin dhe efektivitetin e të gjitha kanaleve të përcaktuara komunikuese.

Informacioni i bërë publik, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.ama.gov.al synoi të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Autoritetit, në drejtim të rritjes së zbatueshmërisë së ligjit dhe rritjes së Imazhit Institucional. Faqja zyrtare e AMA-s është konceptuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm duke përmbushur më së miri jo vetëm detyrimet që rrjedhin nga ligji por edhe duke përmirësuar punën e përditshme si rezultat i mirë koordinimit dhe informimit të saktë të palëve të interesuara. Një element tjetër i rëndësishëm i kësaj strategjie ishte vendosja e kanaleve të komunikimit të dedikuara dhe lehtësisht të aksesueshëm nga publiku.

Angazhimi i Autoritetit në rritjen e transparencës dhe imazhit institucional u konkretizua edhe në muajin shtator me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave në kuadër të hartimit dhe rishikimit të programeve të transparencës, hartimit të kodit/kodeve të etikës së mediave audiovizive si dhe rritjes së ndërgjegjësimin për ruajtjen e të dhënave personale gjatë raportimeve nga media.

Pjesë e kësaj strategjie komunikimi gjatë 2015 ka qenë dhe përqasja e Autoritetit ndaj gazetareve, redaksive të mediave etj duke u investuar në marrëdhënie bashkëpunimi me qëllim zhvillimin e një medie të pavarur, pluraliste dhe profesionale. Marrëveshja e bashkëpunimit me Këshillin e Medias për përdorimin e arkives ishte një ndër hapat në funksion të shkëmbimit të informacionit mes palëve dhe ndërtimit të urave lidhëse.

Autoriteti ka konsideruar pjesë integrale në strategjinë e komunikimit marrëdhënien me aktorët e interesit në Kosovë duke u angazhuar në marrëdhënie bashkëpunimi me KPM për menaxhimin e frekuencave, rregullimin e çështjeve për përmbajtjen e programeve, shkëmbimin e përvojës për hartimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator për komunikimet audiovizive, mbrojtjen e së drejtës së transmetimit dhe të drejtës së autorit si dhe shkëmbimin e informacionit për operatorë të ndryshëm që transmetojnë në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës.


11.2 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore

Duke konsideruar menaxhimin e burimeve njerëzore si një element thelbësor për krijimin e një administrate civile profesionale, të qëndrueshme, efektive dhe të përgjegjshme, AMA ka synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standardet dhe praktikat me të mira evropiane në fushën e medias.

Përmirësimi i mëtejshëm i performancës së administratës së AMA-s, ka përbërë një objektiv të vazhdueshëm të punës së këtij Autoriteti, duke synuar pasjen dhe rekrutimin e nëpunësve civil, të cilët të mund të përballojnë sfidat dhe proceset që diktohen nga zhvillimet teknologjike si dhe plotësimin e standardeve e praktikave ligjore. AMA nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ka organizuar dhe drejtuar punën për zbatimin me përpikëri të legjislacionit të shërbimit civil, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit, zhvillimit të karrierës brenda shërbimit civil, si dhe përmirësimit të sistemit të trajnimit të stafit.

Referuar rezultateve të keq menaxhimit të Burimeve Njerëzore në administratën e AMA-s dhe shkeljeve të ligjit të nëpunësit civil të periudhave të mëparshme të përkthyer këto në dëm ekonomik ngarkuar periudhës aktuale, sipas të dhënave në tabelat e mëposhtme, Autoriteti ka konsideruar përputhshmërinë ligjore dhe efektivitetin në menaxhimin e burimeve njerëzore, objektivin kryesor gjatë 2015.

Shuma ne leke	viti 2011	viti 2012	viti 2013	viti 2014	viti 2015
Shpenzimet nga proceset gjyqesore te humbura nga marredheniet e punes te krijuara sipas viteve	14,763,341	6,183,602	5,957,109	1,330,545	-



Stafi i AMA-s, ka pasur një domosdoshmëri për trajnim në përmbushje të funksionit të tij, si organ mbikëqyrës dhe rregullator i veprimtarisë audiovizive, përmes forcimit të integritetit e pavarësisë së Autoritetit, në përputhje me standardet evropiane të politikave e zhvillimeve mediatike e kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë. Menaxhimi i procesit të trajnimeve është realizuar duke përcaktuar saktë nevojat për trajnim të stafit në përputhje me problematikat e evidentuara gjatë punës së përditshme.

Trajnimet janë realizuar në disa forma, duke filluar nga ato të drejtpërdrejta brenda institucionit, vendit të punës, trajnimet pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), deri te shkëmbimi i eksperiencave me organizmat ndërkombëtar. Gjithsej, gjatë vitit 2015 janë trajnuar 9 nëpunës, pranë ASPA-s.

Gjithashtu, AMA, në muajin shtator nën asistencën e ekspertit të jashtëm, ka zhvilluar trajnimin me temë “Motivimi dhe Sjellja Institucionale” me pjesëmarrjen e 22 nëpunësve të saj, ku stafi është trajnuar mbi etikën, motivimin në ambientin e punës, etika dhe sjellja institucionale, përmirësimin e performancës në kryerjen e detyrave funksionale etj.

Përfshirja e të gjithë punonjësve në objektivat institucionale, mbajtja e tyre të informuar mbi veprimtaritë e institucionit, shkëmbimi i ideve dhe praktikave më të mira me njëri tjetrin shërbejnë si shtylla kryesore për rritjen e performancën individuale të çdo punonjësi por edhe asaj institucionale. Si rrjedhojë, në funksion të rritjes së cilësisë së punës, në mënyrë që punonjësit të përmirësojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, AMA organizoi në muajin tetor një tryezë pune me pjesëmarrjen e gjithë stafit të saj, për një ndarje më të detajuar e më profesionale të proceseve të punës, përcaktimin e objektivave për çdo

njësi, vendosjen e linjave të raportimit, afateve kohore si dhe rrahjen e mendimeve dhe eksperiencave mbi sfidat që AMA pritet të ndërmarrë në vijim.

AMA gjithashtu u mundëson studentëve, të cilët janë diplomuar apo janë në proces diplomimi, një praktikë mësimore, e cila ka për qëllim të sigurojë një këndvështrim praktik si dhe rritje profesionale të studentëve të cilët, falë formimit akademik dhe më pas njohjes me praktikën do të rrisin mundësitë për t'u punësuar më shpejt dhe për të qenë më të përgatitur për punën apo për interesat e tyre në punë kërkimore. Këto praktika mësimore administrohen në bashkëpunim me universitetet publike të Tiranës dhe Kosovës, fakulteti i Gazetarisë me të cilat AMA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

11.2 Ambientet e punës

Lidhur me ambientet e punës ku aktualisht AMA ushtron veprimtarinë e saj, me VKM nr. 468 datë 03.06.2015, është bërë kalimi në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar te Autoriteti i Mediave Audiovizive, të katit përdhes, të katit të parë dhe katit të dytë të godinës me emërtimin “Ateljer për dekorin e Radio Televizionit” dhe i është hequr përgjegjësia e administrimit të katit të katërt dhe të pestë të ish godinës të hotel “Drinit”.



TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

12.

12.1 Shfrytëzimi i burimeve të financimit

Duke konsideruar autonominë financiare një nga elementet kyc në mirëqeverisjen e Autoritetit, si nga përmirësimi i operativitetit ashtu edhe nga rritja e pavarësisë institucionale, përqendrimi kryesor i veprimtarisë së administratës së AMA-s ishte përmirësimi i shfrytëzimit të burimeve të financimit, vazhdimësisë dhe e angazhimeve të marra nga Autoriteti në fundvitin e 2014 ndaj organizmave mbikqyrës.


Ky fokus u përkthye në strategjinë e komunikimit të Autoritetit me ofruesit e shërbimeve mediatike në drejtim të intensifikimit të njoftimeve dhe korrespondencave zyrtare mbi zbatueshmërinë e ligjit, shlyerjen e detyrimeve financiare dhe respektimin e afateve ligjore në shlyerjen e tyre. Hap tjetër i rëndësishëm pjesë e kësaj strategjie ishte rritja transparencës dhe llogaridhënies mbi trajtimin e problematikave rezultat i shkeljeve të dispozitave ligjore. Strukturimi dhe formalizimi i ndjekjes së procesit të vjeljes së të ardhurave nga njësia përgjegjëse në administratën e AMA-s ishte gjithashtu një hallkë tjetër e rëndësishme që përmirësoi dukshëm shfrytëzimin e burimeve dhe rritjen e normës së arkëtueshmërisë.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet realizimi i zërit “Të ardhura nga detyrimet financiare” për vitet 2011– 2015, nga ku evidentohet që norma e arkëtueshmërisë të të ardhurave për vitin 2015 është 80% dhe është 2 herë më e lartë se mesatarja e normave të arkëtueshmërisë së të ardhurave për vitet 2011-2013, e cila rezulton 39%. Gjithashtu nga këto të dhëna shihet qartazi trendi i rritjes së normës së arkëtueshmërisë i cili është në koherencë të plotë me angazhimin e Autoritetit në fundvitin e 2014 për rritjen e zbatueshmërisë së ligjit në drejtim të shlyerjes së detyrimeve financiare brenda afateve të përcaktuara.

TABELA E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE NGA DETYRIMET FINANCIARE TË OSHMA

Arkëtimi i realizuar sipas viteve i të ardhurave vjetore	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Shuma e të ardhurave vjetore	131,455,318	118,061,085	116,958,810	102,413,197	140,277,514
Arkëtimi i realizuar i të ardhurave	60,363,439	43,291,430	42,899,741	61,525,629	111,769,232
Realizimi në %	46%	37%	37%	60%	80%

PARAQITJA GRAFIKE E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE NGA DETYRIMET FINANCIARE TË OSHMA



12.2 Menaxhimi i burimeve financiare

Autoriteti gjatë 2015, ka bërë menaxhimin e burimeve financiare nëpërmjet parashikimeve të buxhetuara në fillim të vitit dhe të rishikuar në gjashtëmujorin e dytë të tij për reflektimin më të mirë në përmirësim të operativitetit në përmbushje të funksioneve ligjore. Në krahasim me vitet e mëparshme, Autoriteti ka rritur ndjeshëm fokusin në rolin e tij mbështetës dhe nxitës lidhur me zhvillimin e studimeve të tregut audiovizual, si dhe sfidat dhe problemet që procesi i afërm i digjitalizimit sjell për Shqipërinë. I vetëdijshëm për përgjegjësinë e tij në rregullimin e këtij tregu si dhe rolit të rëndësishëm të përcaktuar nga strategjia kombëtare në procesin e digjitalizimit, Autoriteti vendosi si prioritet në menaxhimin e burimeve financiare, realizimin e projekteve të parashikuara për procesin e digjitalizimit të përcaktuara dhe në strategjinë kombëtare.

Një tjetër prioritet në menaxhimin e burimeve financiare ishte dhe përmirësimi i imazhit institucional nëpërmjet anëtarësimeve në organizatat e rregullatoreve audiovizive, pjesëmarrja në konferenca dhe tryeza pune. Gjithashtu edhe organizimi i trajnimeve dhe seminareve ishte në fokus gjatë buxhetimit në menaxhimin e burimeve financiare me qëllim përmirësimin e njohurive teknike, dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit.

12.4 Treguesit financiar të subjekteve

BILANCI KONTABËL NË DATË 31 DHJETOR 2014 DHE 31 DHJETOR 2015		
	(në Lek)	
AKTIVET	31.12.2015	31.12.2014
I. Totali i Aktiveve Afatshkurtra	385,826,039	344,347,540
- Gjendje Inventari	2,582,335	2,098,503
- Kërkesa për arkëtim ndaj të tretëve	302,138,821	302,342,284
• Klientë për licenca	72,043,762	97,231,993
• Klientë për tarifën për shërbime RTV	12,436,424	8,748,959
• Klientë për gjoba	216,650,608	196,361,332
• Klientë për kamat vonesa	1,008,027	-
- Të tjera kërkesa ndaj të tjerëve	191,782	197,889
- Arka dhe Banka	80,913,101	39,708,864
II. Totali i Aktiveve Afatgjata	19,897,564	20,465,939
Aktivet e qëndrueshme, të pa trupezuara	3,798,277	90,000
Aktivet e qëndrueshme, neto	16,099,287	20,375,939
III. Totali i Aktiveve	405,723,603	364,813,479
IV. Fondet baze	197,709,647	212,924,734
V. Rezultati ushtrimor i vitit	(123,250,627)	(15,215,087)
VI. Detyrime ndaj të tretëve	331,264,583	167,103,832
• Detyrimet mbi klientët	218,937,286	167,103,832
• Detyrime ndaj furnitorëve	67,590	-
• Detyrime ndaj shtetit për tatime dhe kontribute	911,137	-
• Detyrime për kreditorë të viteve të mëparshme	111,348,570	-
VII. Totali i pasivit	405,723,603	364,813,479

PASQYRA E TË ARDHURA DHE SHPENZIME VITET 2014 – 2015			
	(në Lek)		
Nr.	Emërtimi	Viti 2015	Viti 2014
A	Të Ardhurat korente të periudhës	151,734,678	125,674,955
1	Të Ardhura nga Licenca/autorizim	132,362,046	108,643,403
2	Të ardhura si agjent tatimor	865,594	846,475
4	Të ardhura nga përpunimi administrativ	3,720,000	2,060,000
5	Të ardhura nga interesat bankare	185,796	104,987
6	Të ardhura të tjera nga gjobat, kamat vonesa	14,601,242	14,020,090
B	Shpenzime Administrative	192,196,676	67,860,095
1	Shpenzime operative	10,450,671	6,593,378
2	Shpenzime personeli	59,705,639	56,218,621
3	Shpenzime Taksa Vendore	11,770	0
4	Shpenzime gjyqë, legale	122,028,596	5,048,096
C	Shpenzime të Veprimtarisë funksionale të AMA-s	14,540,828	4,634,761
1	Konferenca dhe Studime tregu	2,622,134	-
2	Kuota Anëtarësimi dhe shpenzime përfaqësimi	5,981,894	4,634,761
3	Shpenzime për Projektet për Digjitalizimin	5,936,800	-
D	Shpenzimet e Jashtëzakonshme	50,600,500	60,869,812
1	Parashkrim gjobash	40,120,000	400,000
2	Heqje licence/autorizim	10,480,500	60,469,812
E	Amortizime të aktiveve të trupëzuara	16,528,633	7,525,375
F	Transferta për organizatat e huaja	1,118,667	-
G	Rezultati Financiar	(123,250,626)	(15,215,088)

1. Në zërin “Shpenzime të jashtëzakonshme: janë përfshirë humbjet nga parashkrimi i gjobave të viteve të kaluara të pa ekzekutuara dhe humbjet nga debitorët të cilëve ju është hequr ose bërë e pavlefshme licenca/autorizimi, me vendim të KKRT/AMA.
2. Për vitin 2014, me vendimet e AMA-s, nr. 18, 20 – 23, datë 17.12.2014, janë shfuqizuar disa sanksione me gjobë, gjithashtu janë njohur si humbje detyrimet financiare për subjektet debitoare të hequr licenca nga KKRT/AMA, në vitet e mëparshme.
3. Për vitin 2015, me vendimin, nr. 68, datë 10.07.2015, AMA ka parashkruar gjobat të cilat sipas afateve ligjore duhet të shuhen për sa nuk është kryer ekzekutimi i tyre brenda afatit të caktuar nga ligji dhe me vendimet e AMA-s nr. 47 – 52, datë 11.06.2015, janë bërë të pavlefshme licencat dhe autorizimet, për disa subjekte debitor.
4. Zëri i “Shpenzimeve gjyqësore legale”, janë përfshirë proceset gjyqësore të viteve të mëparshme, të kthyer në tituj ekzekutiv gjatë vitit 2015 sipas viteve përkatësisht viti 2011 në shumën 2.901.940 ALL, viti 2013 në shumën 117.188.278 ALL (detyrimi ndaj Media+ TV Shijak), viti 2014 në shumën 775.281 ALL.



12.4 Treguesit financiar të subjekteve

Në zbatim të pikës 1/g, të nenit 33 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, AMA, ka njoftuar subjektet radiotelevizivë që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2014, mbi detyrimin ligjor për të depozituar pasqyrat financiare vjetore, të hartuara në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe të konfirmuara me numrin dhe datën e dërgesës postare.



Në mbyllje të vitit 2015, nga 255 operatorë të cilët kanë pasur aktivitet gjatë vitit 2014, kanë dorëzuar pasqyrat financiare 183 operatorë ose 71 % e operatorëve. Nga këta, kanë depozituar pasqyrat financiare 45 operatorë radio, 50 operatorë Televizivë, 84 operatorë TV me kabëll, 3 operator televiziv numerik dhe 1 operator ofrues programi. Situata financiare e operatorëve që kanë dorëzuar pasqyrat financiare rezulton sipas tabelës dhe paraqitjeve grafike të mëposhtme:

Nr.	EM Ë R T I M I	Operatore me fitim	Operatore me rezultat zero	Operatore me humbje
1	Operatorë Radiofonike	26	2	17
2	Operatorë Audioviziv	35	2	13
3	Operatorë me Kabëll	72	2	10
4	Operatore Numerike	2	1	0
5	Operatore Ofrues programi	1	-	-
	Gjithsej	136	7	40


Shpërndarja e operatorëve me fitim





Shpërndarja e operatorëve Audioviziv



Shpërndarja e operatorëve me Humbje



Shpërndarja e operatorëve kabllorë



Adresa: Rruga "Abdi Toptani",
Tiranë, 1001.
Tel: +355 4 222 6288
Cel: +355 66 20 44 909
e-mail: info@ama.gov.al
www.ama.gov.al